

BIBLIOTEKA
SHTETIT

856-2
M 78.

Hamza Minarolli



...Shënomëni dhe mua!

DRAME

8 Sh-2
M+8

HAMZA MINAROLLI

...Shënomëni dhe mua!...

dramë në 4 akte



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

V E T A T:

- LUFTARI** — i deleguari i partisë për zonën e Rrëzës
- BESNIKU** — sekretar i organizatës-bazë të Partisë së fshatit
- RRAPO SHKËMBI** — fshatar i lidhur ngushtë me pushtetin, kryetar këshilli
- FATKA** — fshatar, komunist
- HYSKA** — fshatar, bashkëpunon me forcat e ndjekjes
- PIRRO** — i ri fshatar, komunist, bashkëpunon me forcat e ndjekjes
- SELVIJA** — gruaja e Rrapos
- SHEGA** — e bija e Rrapos
- LULJA** — nusja e djalit të Rrapos
- KASO** — fshatar i mesëm
- TELI** — » i varfër
- ALIU** — » 90-vjeçar
- NURKA** — djali i Kasos
- MALIQI** — fshatar i mesëm
- RUSTEMI** — fshatar, bujku më i mirë i zonës
- JANI** — kryetar i grupit të kulakëve
- DAUT ZULLUMI** — kulak

SANIE HANËMI — *bejlereshë*
NURIJA — *E motra e Sanijes*
BEKTASHI — *i shoqi i Sanijes*
PILOJA — *plak i moshuar*
FATIMJA — *grua fshatare, e ve me tre fëmijë të vegjël*

MJEKU

BANDITI

OFICERI I FORCAVE TË NDJEKJES

FËMIJA

GRA, BURRA, FSHATARË, USHTARË TË FORCAVE TË NDJEKJES

(Ngjarja zhvillohet në një fshat të jugut.)



P J E S A E P A R È

AKTI I PARE

Një dhomë fshati e thjeshtë. Në vatër ka zjarr. Anash një pjesë e oborrit të shtëpisë. Një pus. Shega, duke larë rrobat, këndon lehta. Vjen Lulja (shtatzënë në mua jin e fundit) për të mbushur ujë.

LULJA — Po këndon, ë?

SHEGA — Ka ditë, Lule, që kam dëshirë vetëm të këndoja.

LULJA — (E ngacmon.) E po domosdo, do bëhesh nuse e re në shtëpi të re. E pashë Pirron tek punonte. Edhe ai këndonte dhe mua m'u bë sikur të këndonte ty dhe shtëpisë së re që po ndërtonte.

SHEGA — U dërrmua i ziu: sa në arë, sa në ndjekje, aq edhe me shtëpinë.

LULJA — Thonë, Shegë, se ata që dashurojnë janë shumë të fortë. Ti ç'thua?

SHEGA — Gjersa thonë, diç do të jetë. (Pauzë.)

RRAPOJA — O Selvi? C'ma bëre atë copë kalem, moj?

SELVIJA — (Nja brenda.) Aty e ke. S'ta nget njëri, jo.

LULJA — Po babait si do t'ia bëjmë, se?

SHEGA — Ku di unë e zeza! Tani atij s'i flitet. Ka hallin e kooperativës.

LULJA — (E ngacmon.) E pse s'ia thotë Pirroja vëtë?

SHEGA — Po ai do t'ia thotë, po kush, unë? Kurrë! Ta kisha Asimin e motrës këtu, mund t'ia kisha thënë.

LULJA — Asimit ia thosha unë që natën e parë.

SHEGA — Po ti ç'thua, Lule, do pranonte Asimi?

LULJA — (E vendosur.) Do pranonte.

SHEGA — È nga e di ti, se do të pranonte?

LULJA — E di, se ia kam thënë dhe dje më ktheu përgjigjen.

SHEGA — (Tepër e interesuar.) Më qafsh, ç'thoshte?

LULJA — (Nxjerr letrën nga gjiri dhe lexon.) «Shega të ketë durim, se kur të vij me leje do ta mbaroj vetë këtë punë me babanë».

SHEGA — T'u bëftë motra, o Asim! Xhani i motrës! (Lulja mbush enët dhe matet t'i ngrejë.) Të-të-të! Jo ti, më qafsh, Lule, se të kemi hazër. (Ia kap enët.)

LULJA — Për kokën tënde, s'janë hiç të rënda.

SHEGA — Pu, pu, pu, s'bëhet ajo! Le që na vrau bai; po na pa.

LULJA — Dua edhe unë të lëviz ca, moj Shegë. Edhe (Asimi kështu më shkruante) i kishte thënë një doktor, që duhet të lëvíz. (Ngre enët e niset. Në këtë kohë del Rrapoja dhe e sheh nusen.)

RRAPOJA — Po mos, moj nuse, moj bijë, mos këshfu!

(Shegës.) Po ti, moj mistrece, ç'më rri e më bën sehir, ë?!

LULJA — S'janë të rënda, baba, jo. (Rrapoja futet brenda. Në këtë kohë Pirroja afrohet te gardhi. Lulja largohet. Shega bën sikur s'e ka parë.)

PIRROJA — Thua vërtet s'më pe, moj Shegë?

SHEGA — As të pashë e as të ndjeva.

PIRROJA — Zërë pér kokën time!

SHEGA — E pse të ze? S'beson ti, kështu?

PIRROJA — Kur gënjejnë njerëzit s'u besoj hiç.

SHEGA — U më març të keqen.

PIRROJA — Ç'ke të këqia leri në derë të tyt eti dhe kur të të marr të dua të më vish me gjithë të mirat.

SHEGA — Kështu siç e ke nisur, pér të marrë më ke.

PIRROJA — Mos më nxeh, se të rrëmbeva që sonte.

SHEGA — S'je aq trim sa thua, jo. Po të ishe trim, ia thoshe tim eti.

PIRROJA — Baba e ke, po s'e njeh. Dysh nuk bëhet ai, jo. Po nuk ngriti kooperativën, nuk të le ai t'i hapësh muhabet tjeter, jo.

SHEGA — (Më qëllim.) Se mos po të ishte Asimi këtu do t'i thoshe?

PIRROJA — Pér kokën tënde do t'ia thosha sapo ta takoja.

SHEGA — Po sikur ai të ta priste shkurt: «punë që s'bëhet»?

PIRROJA — S'thotë «s'bëhet» Asimi, jo.

SHEGA — E nga e di ti që s'thotë?

PIRROJA — Sepse e njoh mirë, siç njoh veten.

SHEGA — Do të të them një fjalë, por ama, jo e dë-

gjove këtë e të heqësh dorë nga babai. Vulën tonë babai e vë, dëgjove?

PIRROJA — Ec ti, ec, se e di unë atë, po hë, thuaj ç'ke pér të thënë!

SHEGA — Asimi do.

PIRROJA — Të thashë unë.

SHEGA — I kishte shkruar Lules letër dhe atje i thoshte se do ta rregulloj unë punën e Shegës me Pirron, porsa të vi me leje. Të keqen motra!

PIRROJA — Pesë me një, demek, ë?!

SHEGA — Ç'thua, more?

PIRROJA — Po ti e unë dy, nënë Selvija tre, Asimi katër, fut dhe Lulen, pesë kundër Rrapo Shkëmbit.

SHEGA — Po mos harro që është shkëmb ai, se.

PIRROJA — Pse, tunelet që hapëm më hekurudhë, s'qenë shkëmb, a? (*Ndërkohë është afruar pa u vënë re Hyska.*)

HYSKA — Po, ama, ka shkëmb e shkëmb.

PIRROJA — Këmbë maceje ke, o t'u mbylltë! As të ndjen njeriu kur ecën.

HYSKA — Po pse si i do ti t'i kem, putër ariu, që të ma dëgjojë armiku hapin që një orë larg? (*Ngacmon.*) Si shumë të émbël e të shtruar e kishit muhabetin! Shiko se...

PIRROJA — Ec ti, ec, se s'ta ka frikën njeri ty, jo.

HYSKA — Mua vërtet s'ma kini frikën, po nga xha Rrapoja u dridhen leqet e këmbëve të dyve. Nejse. (*Pirros.*) Dëgjo këtu. Po vjen shoku Luftar.

PIRROJA — Vërtet thua, more?!

HYSKA — Xheku vajti me Fatkën e drejt e këtu i ke. Shko i thuaj Rrapos. Unë po u dal përpara. (*Hyska largohet, kurse nga shtëpia dalin Sel-*

*vija dhe Lulja me nga një kanistër me plaçka.
Pas tyre del Rrapoja i nxehur.)*

RRAPOJA — Kaq herë të kam thënë, moj lanete, që mos ma ngarko nusen! (*Ato qëndrojnë në vend.*) Në s'i bëni dot ti me Shegën ato punë, thomëni mua, po jo asaj.

SELVIJA — Ç'ne, mor i uruar, unë. I thashë, po s'i mbushet mendja. «S'ka gjë, nënë, s'ka gjë, se s'janë të rënda» më thotë.

RRAPOJA — Lëre, moj, ç'thotë ajo, se ti e di më mirë se unë këtë punë.

SHEGA — Edhe unë i thashë, baba.

RRAPOJA — Hë, pusho aty! Ku e thëna, ku e bëra. (*Pirros.*) Po ti, mor karafil, ç'bën aty te gardhi?

PIRROJA — Kush, unë??!

RRAPOJA — Ti o, po kush, hunjtë!

PIRROJA — Erdha se kisha punë me ty.

RRAPOJA — E po në kisha punë me mua, mos rri e më bëj sehir si i lajnë teshat gratë, po eja brenda.

PIRROJA — Ka ardhur shoku Luftar. Do të vijë këtu.

RRAPOJA — Shoku Luftar, the? Hë... Po mirë se të vijë! Ai i shtëpisë është. (*Lules.*) Lere, moj nuse.

LULJA — Po dua të bëj diçka edhe unë, mor baba.

RRAPOJA — Ti të na bësh një djalë, atë të bësh.

PIRROJA — S'të shoh në qejf sonte, ç'paske kështu?

RRAPOJA — Pse ç'kërkon ti, të zbardh dhëmbët, që të të engledis ty, a?

PIRROJA — Apo mos ta ka prishur gjakun prapë Daut Zullumi?

RRAPOJA — Mos m'i ndiz më tepër fitilat, se edhe emrin s'ia dëgjoj dot.

PIRROJA — Erdhën, xha Rrapo. Ja tek i ke:

RRAPOJA — Të thashë de, mirë se të vijnë! (*Luftrit.*) Mirë se erdhe!

LUFTARI — Mirë se të gjeta, xha Rrapo. (*Takon me radhë Selvinë, Lulen, Shegën, Pirron.*)

RRAPOJA — Epo, urdhëroni brenda. Besnikun e takove?

LUFTARI — Më thanë se është te xha Aliu. I dërgova fjalë që jam këtu.

RRAPOJA — E po, uluni, uluni, de, ç'më nusëroni këshfu. Dridheni një herë nga duhani im. Është një çikë i fortë, por është i mirë. (*Pauzë.*) Sot e kam humbur fare, more djema, e s'po e gjej dot radhën e fjalës, jo. E po si më je me shëndet e me punë, more Luftar, ë?

LUFTARI — Po mirë, o xha Rrapo, Punë sa të duash e me shëndet s'qahemi, jo. Po ju këtej?

RRAPOJA — Ne këtej me shëndet top, por punë e telashe sa të duash. E po, ele, ele ç'erë e mirë të solli përsëri?

LUFTARI — E po dola një herë, o xha Rrapo. Dola të shihemi e të këmbejmë ndonjë mendim për punët e kooperativës.

RRAPOJA — Po ti njëditëzaj ishe këtej. Hë.. Mos na ka pjellë ndonjë proçkë tjetër këshfu, a?

LUFTARI — Jo, bre, xha Rrapo, po unë s'vij vetëm për proçka këtej.

RRAPOJA — Jo po thashë, de. Ti për të mira ke ardhur dhe ardhç përherë, more bir, po sepse po na ndodhin këtej ca gjëra që s'honepsen hic.

LUFTARI — E po, domosdo që do të na ndodhin edhe gjëra jo të mira gjersa jemi akoma në lüftë. Po puna është, xha Rrapo, që kur ngecim apo s'na shkojnë punët mirë, të ndalemi e t'i shkoqisim

psë:s'na venë:mirë, por ama duke e nišür që
nga vetja jonë, Si këmi punuar ne? Ç'kemi bë-
rë e ç'kemi lënë pa bërë? Ç'duhet të bëjmë pas
kësaj! Pastaj, duhet të shohim kush na i nga-
tërron punët? Pse? Ç'emér t'i vëmë e ç'qëndrim
të mbajmë? I thonë luftë klasash kësaj, xha
Rrapo. Kemi dhe armiq. Po t'i kemi parasysh të
gjitha këto, punët medoemos që do të na venë
edhe më mirë. È, Pirro? A po jo, mor Fatkë?

FATKA — Njëshkë do të na venë, shoku Luftar, si
s'do na venë.

RRAPOJA — Po i bie anës e anës, more bir. A nuk
më hyn dréjt e në thëla, së s'po më durohet
mua!

HYSKA — Iu ndezën fitilat Rrapos.

RRAPOJA — Jo po ujë i vakët kështu si ju. Që kur
më tha Pirroja se kishe ardhur ti, më dogji
mua.

LUFTARI — Pse, mës e ke mizën në shapkë?
RRAPOJA — Mor po lëre mizën time ti, po pa më
thuaj këtu: mos janë ankuar gjë prapë ata?

LUFTARI — Po. Prapë janë ankuar!
RRAPOJA — E si demek? Si ahere kur ishte Re-
xhepi?

LUFTARI — Ca më keq.
RRAPOJA — E si më keq?

LUFTARI — Po ja, mor xha Rrapo, sikur ju të Pi-
shës bëni ca si me kokën tuaj.

HYSKA — Ne sëpas kokës sonë? Gënjejnë maska-
renjtë.

LUFTARI — Ta shohim.
RRAPOJA — Oj, ta shohim thua? Ta shohim që ç'ke
më të!

LUFTARI — Janë ankuar se ju kini kërcënuar një-rëzit për të hyrë në kooperativë.

RRAPOJA — Jo more? Mos kanë thënë që i kemi zhdëpur dhe në dru, a?

LUFTARI — Në mos aq, aty afër kini vajtur.

HYSKA — Mos është fjala për atë zënkën e Besnikut me Rushitin?

RRAPOJA — Mbylle, mor ti, për çfarë zënke po më flet! Është shpifje, o Luftar. Është gjetkë dhëmbi që kafshon. E di unë, e di. Hë, gjidi sojsëzë, gjidi sojsëzë!

HYSKA — E po dale, o Rrapo. Ka të drejtë shoku Luftar. Bëri bujë në gjithë fshatin ai muhabet.

RRAPOJA — S'paska marrë dhenë, a. Të vënë mend qenat. Dhe ti mos m'i fryj gjërat kështu. Ashtu, de!

HYSKA — Jo de, jo...

RRAPOJA — Pa rri aty ti, Hyskë, e mos m'i ngatërrro numrat mua! Oj! Ku Xhyra, ku Elbasani. Ai u kap pér punën e grumbullimeve e jo pér kooperativën. Ashtu, de.

HYSKA — Po mirë, or mirë, po pse e merr me të nxeh të?

RRAPOJA — Unë mend tèrbohem, ti më thua mos u nxeh! (Luftarit.) More bëj, ky ligji i ri i grumbullimeve, apo sistemi i ri, si i thonë de, u ka dogëndisur ca si tepër kulakëve dhe ata, ngaqë janë mbushur vrer, venë e ua derdhin këtë njerëzve tanë e këta zenë lajthitin pastaj.

HYSKA — Njerëz janë, edhe lajthitin. Po kulakë s'i bën dot ata, o Rrapo.

RRAPOJA — Kulakë s'i bëj, or jo, por edhe për të duruar s'i duroj dot kur më grazhdojnë në një

grazhd me kulakët, se, si i thonë asaj fjalës,
«geni atje ku ha, atje leh». Dëgjove? (Luftarit.)
Ti i di vetë këto punë, more bir, si i deleguar
që je, por unë them që këtu ka dorë mavija.

LUFTARI — Edhe unë me atë mendim kam ardhur,
xha Rrapo.

RRAPOJA — Dhe mirë e ke shënuar.

HYSKA — Për ashtu, është i regjur me pishanakët
Rrapoja, o shoku Luftar, dhe ka hundë të ho-
llë pér kësi punësh.

RRAPOJA — Shiko se më vure në gjumë me këto
fjalë, o Hyskë. (*Hyn Selvija dhe sjell rakinë.*)

SELVIJA — Ja, mirë se erdhët!

LUFTARI — Për të mira dhe pér gëzime jua pifshim!

RRAPOJA — Mirë se më erdhët dhe ju lumshin kë-
mbët!

FATKA — Gëzuar, nënë Selvije!

SELVIJA — Gëzuar qofshi, bijtë e nënës!

PIRROJA — Gëzuar, xha Rrapo!

RRAPOJA — E o, mirë. Gëzuar! Pi macja uthull.

LUFTARI — E po q'thotë Asimi? A ju ka dërguar
ndonjë letër tani shpejt?

RRAPOJA — Dje morëm. Mirë shyqyr, mirë është.
Me punë shumë, thotë, dhe me mall pér ne.

SELVIJA — Ai pér ne e ne pér të. Ai Asim na ka
mbetur tani.

RRAPOJA — E, e, mjaft m'u skinje tani! E pse, moj,
vetëm ai na paska mbetur? Po këta, moj, këta
që kemi këtu s'janë djemtë tanë?

LUFTARI — Mirë e the, o xha Rrapo!

SELVIJA — Mirë e tha, të keqen, po unë jam nënë
dy herë e djegur dhe tani ai Asim më ka mbetur,
se çupa është derë e botës, mirëpo, edhe
atë e kam larg, në Tiranë...

RRAPOJA — Po ku do ti ta kesh, moj e uruar, ë? Atje i thotë Partia dhe Komandanti, atje punon dhe ai. Dhe mirë bën. Ja, neve na ka lënë nusen dhë ajo është me ditë pér të lindur e pa staj do të bëhem me nipçë.

LUFTARI — Ose me njibesë.

RRAPOJA — A, jo! Dy të parët ia dua djem, se dua tē ngjall Hysminë dhe Rizanë. Pastaj, po qe e zonja, një duzinë me çupa le të bëjë. (Të gjithë qeshin.)

SELVIJA — Ato punë s'dihen, plak, se janë punë të perëndisë.

RRAPOJA — Të kujt, të duan le të jenë, plakë. Mua is'më duhet. I ati bëri tre djem e ai të mos bëjë dot dy. Ec, ti, ec se do t'i bëjë. Dëgjo plakuni ti.

SELVIJA — Ishalla, të lumtë goja!

RRAPOJA — Po goja do përkëdhelur, o Selvi!

SELVIJA — Edhe unë do të ta përkëdhel. Po s'të të holla një bakllava, po m'u thafshin që në rëzë.

RRAPOJA — Po, ama, ta hamë kështu siç jemi sot, ë?

SELVIJA — Edhe ca të tjerë, pa këta po e po. (Qeshin të gjithë) Ika unë, djemtë e nënës, ika se ju lashë pa punë.

RRAPOJA — Kjo dynja, more bir, ka vërtet njerëz të mirë, por ama ka edhe maskarenj dhe nga ky takëmi i dytë veç zullumeve dhe ngatërre save, mos prit gjë të mirë.

FATKA — Mirë thotë. E pastaj, o Hyskë, po shkove pas brumbujve, në plehë do të përfundosh, se s'bën.

RRAPOJA — Ashtu, posa. Prandaj u duhet vënë gishti e duhen shtypur këta brumbuj.

HYSKA — E po ec e vëre atë gisht, se. Ku? Kujt?

PIRROJA — (Fatkës.) Prit kur të thotë «Dautit të parin!»

RRAPOJA — (Pirros.) Plaq të preftë!. Mbylle, e mos m'i ndis më tej fitilat! Po pse, mor viç, në thënça Dauti, s'bie në shenjë, a?

LUFTARI — Domosdo që kulakët janë në këtë mes. Siç e tha edhe xha Rrapoja, sistemi ynë i ri i grumbullimeve dhe i furnizimit, veç të tjerave, ua preu dorën për të gjitha ndyrësirat që bënin në tregun e zi. Ata me atë treg donin ta armiqësonin punëtorin me fshatarin, qytetin me fshatin, kurse ne me sistemini e ri duam t'i bashkojmë sa më shumë.

RRAPOJA — Ashtu, de. E dëgjove? Qepe tan!

FATKA — Or po ke parë ti, ne na ranë këmbët duke bredhur derë më derë e duke folur e qarë hallet me njerëzit, kur fap, pa pritur, të del gjurma e tyre. Isha njëditëzaj te xha Leksi. E nisëm muhabetin mirë e shtruar, kur pa pritur iku xha Leksi nga binarët. «Or po na lini rehat, se mirë jemi dhe kështu, po më thosh, pse na detyroni». E fjalë pas fjalë filloj të shthurej fare.

M'u desh të rrija gjer natën vonë. More xha Leksi, i thashë, ne rahim vetëm për të mirën tonë, bre. A e di zotrote që duke qenë të bashkuar edhe shteti e ka më të lehtë për të na ndihmuar me farë, e me mjete e me makina, me kredi e me çdo gjë tjeter. Pastaj i fola gjerë e gjatë për të mirat e kooperativës. Ai filloj të shtrohej e të më dëgjonte e më në fund e nxori: «Ka gojëra të këqija fshati ynë, more bir. Po s'u mbyllën këto gojë, pisk do ta keni me një takëm si unë.»

RRAPOJA — Mirë e the, o Fatkë. Ata maskarenj se

ku ua kamë gjetur një takëmi atë burgjinë e dobët e venë e ua lirojnë edhe ca më tepër. S'do Krasoja me Telin të hyjnë në kooperativë. Po domosdo që s'duan, gjersa në shtëpinë e tyre hyn e del Daut Zullumi.

LUFTARI — Ahere po qe se ai vete një herë tek ata, ne duhet të vemi dhjetë herë.

FATKA — Edhe ne atë po bëjmë. Besoja, si sekretar organizate, s'u është ndarë kurrë. Ndryshe me të tjerët, mor vëlla, ndryshe. Isha te xha Musai, po ai ndryshe, mor vëllezër, ndryshe. As më priti t'ia hap muhabetin për kooperativën, po ia nisi vetë. «Hë, more bir, si po na venë punët me kooperativën. Kur do ta ngrejmë? E ngritën Drithasit, — më tha. — Atyre m'u lumtë, kurse neve s'na falet. Mos u kurseni, dje ma, se është për të mirën tonë. Unë jam me të parët».

RRAPOJA — Ai, Myrtoja, Lazja e... tërë ajo mëhallë e fukarenjve janë njësh për kooperativën, po ç'ti bësh kësaj lagjes së sipërme që ma ka çi-
banin mu në mes. (*Del Selvija e shqetësuar dhe shkon te Shega.*)

SELVIJA — Leri plackat, se s'është mirë nusja.

SHEGA — Lulja, moj?

SELVIJA — Hidhu shpejt te tetë Polja, po, ama, unë thashë «s'ke vajtur» ti të jesh këtu.

RRAPOJA — Hë, moj, ç'është?

SELVIJA — Hiç, hiç.

RRAPOJA — Oj hiç, më thotë, si moj hiç?

SELVIJA — Shiko punën tënde ti.

RRAPOJA — Ma humbi fillin! Ku e kisha fjalën?

PIRROJA — Te çibani i lagjes së sipërmë.

RRAPOJA — Aty e kisha vërtët. More bir, kjo Pisha

jonë i ka punët më të ngatërruara se të tjerat, se këtu e kanë patur folenë e tyre bejlerët e Rrëzës si Bektash beu me shokë. Aty e kemi edhe sot. Vërtet duke dhënë shpirt e pa dhëmbë, se ia shkulëm dhëmbë e dhëmballë q'pat, por helmin gjene e derdh.

LUFTARI — Ke të drejtë, o xha Rrapo. Ashtu është. Veçse filli i kësaj pune shkon edhe më larg, gjer përtej kufirit.

RRAPOJA — A thuq vërtet, more bir?!

LUFTARI — Po, po, o xha Rrapo. Edhe kjo bandë që na ka mbirë këtej si kërpudhë, andej e ka kokën. Kjo doli fare qartë edhe në Plumin e fundit të Partisë.

RRAPOJA — Mor shoku Luftar, do të të them një fjalë.

PIRROJA — Doli prapë Dauti, o Fatkë.

RRAPOJA — Plaç të preftë, mos më ngatërrro mua! Do të them një fjalë. Se si më duket ai sorollipi i Bektashit, tamam çiban. Sikur ta shkulnim me rrënje e ta degdisnim gjékundi.


LUFTARI — Po qe nevoja edhe atë e bëjmë.

RRAPOJA — Edhe një fjalë kam, o Luftar. A nuk ma futni brenda atë Dautin, Daut Zullumin dhe të ma shkundni një herë mirë, se pa gjë s'ka për të dalë, jo??

LUFTARI — Si kështu, xha Rrapo? Pa fakte? S'mund ta bëjmë një gjë të tillë. I thonë pushtet populor.

RRAPOJA — Or po dëgjomëni mua!

LUFTARI — Po të jetë ashtu, marrim e fusim brenë gjithë bejlerët e kulakët e Rrëzës dhe njëri prej tyre do të jetë ai që kërkojmë se s'bën. Pa fakte, s'bëhet ajo punë.



RRAPOJA — E po unë plaça, po s'ta gjeta një fakt pér atë maskara.

LUFTARI — Ashtu, po. Ashtu ndryshon puna, xha Rrapo.

PIRROJA — Mor po ai që shkel në këto punëra, shkel, po ç'e do që gjurmë s'lë.

LUFTARI — Po qe se shkel, duhet të lerë edhe gjurmë, o Pirro, dhe po qe se i lë këto gjurmë, është fajt ynë që s'po i gjejmë dot.

RRAPOJA — Mirë thotë. Ne e kemi fajin. Ja ti, o Pirro, unë, Hyska, Fatka, shokët tanë. Kështu është, pos! Mos presim të na dalë me flamur Dauti, që të biem në gjurmë të tij?! Po kur ju them unë, ma merrni pér ters.

FATKA — E po, jo edhe ashtu siç bën ti, de, s'bën ashtu. Ka ligje shteti

RRAPOJA — Po atë avaz ti, o t'u mbylltë.

LUFTARI — Dale, xha Rrapo, dale, se edhe unë di diçka. Ka të drejtë Fatka. E di ti që ai është ankuar pér rrahjen që i ke bërë.

RRAPOJA — E pastaj çfarë? Mos kërkon ta kisha vrarë fare? (*Luftari i jep një cigare, ia ndez.*)

LUFTARI — Është me zarar kjo punë, o xha Rrapo. Ai mund të të hedhë edhe në gjyq.

RRAPOJA — Ej! Pér këtë më qenke sëkëlldisur ti, mor bir, a?!

LUFTARI — Nuk është e pakët, jo. Nuk bën kështu. Ty të kemi dhe kryetar.

RRAPOJA — (*Preket thellë, shuan cigaren që i dha Luftari dhe ia kthen.*) Na, merre!

LUFTARI — Dale, de! Mos u'nxeh kaq shpejt! Edhe me mua kështu?!

RRAPOJA — Edhe më ty, pos! Nuk më thua me kë je ti, mor bir, me mua apo me kulakun?

LUFTARI — Me ty, bre, me ty, ç'ne me kulakun,
por...

RRAPOJA — E po, unë kulakun rraha, nuk rraha
njeriun tonë, de.

FATKA — Mirë, or mirë, po s'e lejon ligji se.

RRAPOJA — Oj, ç'më plasi ky! Cili ligj s'e lejoka,
more, ligji i tyre apo ligji ynë?

LUFTARI — Ligji ynë, xha Rrapo, ligji ynë.

RRAPOJA — E po, shiko, or bir, se ai ligj që thua ti,
ose është shkruar gabim, ose një takëm e lexoj-
në së prapthi, ndryshe s'ka si të jetë i tillë ligji
ynë, jo.

FATKA — Ec e foli Rrapos për këtë punë. Ters që
ters ta merr!

RRAPOJA — Po domosdo që ters jua marr, gjersa
nuk pyesni pse e si e rraha, po nisni e më qor-
toni, sikur të isha fëmijë.

HYSKA — E mo, po mirë ia bëri atij maskarai.

RRAPOJA — Ashtu është, o pos! Si të mos e rrighja
maskaranë. Pyetmë një herë e pastaj gjykomë.

LUFTARI — E po hë, pa na thuaj!

RRAPOJA — Ç'ta djallos, ta them tani, gjersa më
gjykonit kështu. Oj, të rri unë e të duroj Daut
Zullumin me shokë, se kështu juash dashka qefi
juve! Or po kur tjetri ta bën borxh, s'durohet,
de!

LUFTARI — E po si, de, si?!

RRAPOJA — (I nxehur.) Le t'jua thotë Fatka, meqë
e ditka.

FATKA — E ç't'jua them unë? Ti e rrahe, se mos e
rraha unë.

RRAPOJA — E po, meqë t'u ankua ty, de! (Sheh Pi-
ron që qesh.) Po ti ç'ke që zbardh dhëmbët,
more?

PIRROJA — Pse edhe sot ta kishte prishur gjakun Dauti. Turfulloje i téri qëpari.

RRAPOJA — Se mos vetém sot. Çdo ditë ma prish gjakun ai lanet (*Luftarit.*) Oj, po ke parë ti kështu? S'ka ditë të dal e të mos më dalë përpara ai. (*Sheh Selvinë që del prapë e shqetësuar e thotë me vete.*) Mor, po kjo ç'ka kështu, që s'zë vend sot, ë? (*Luftarit.*) Dëgjo këtu ti dhe pastaj gjykomë.

LUFTARI — Urdhëro e fol, xha Rrapo.

RRAPOJA — Ashtu, de. (*Fatkës.*) Kur bëri vaki kjo zënkekë, mor Fatkë?

FATKA — Po ka nja 2-3 javë, o xha Rrapo

RRAPOJA — Mirë thua, aq ka. (*Luftarit.*) E që thua ti, more bir, po kthehesha në fshat. Kishte rënë nata. Kur arrita te Luadhet e Mujos, ndjeva zhurmën e një tajareje. Domosdo që ishte nga ato të inglizit, që hedhin ato fletushkat kundër nesh. M'u prish gjaku e shpirti m'u mbush me vrer, po s'kisha ç'ti bëja tajares me belgjikun tim. (*Prapë sheh Selvinë që del e hyn e shqetësuar e ai asaj.*)

Moj po ti, ç'dreqin ke kështu sot, ë?

SELVIJA — (Nga jashtë.) Hiç, hiç! Shih punën tën-de.

RRAPOJA — Nejse... E që thua ti, mor bir, s'kisha bërë as dhjetë hapa, kur prapa një ferre dëgjoj një «fsh!». Qëndrova në vënd dhe vura veshin të përgjoj. Pashë një hije njeriu rënë më gjunjë. «Po ky ç'të jetë? — thashë me vete. Mos është ndonjë diversant e diç pret nga tajarja?» dhe fësht dorën në belgjik. Iu afrova. E njoha. Ai ishte, Dauti. Qe ulur më gjunjë, me sytë drejt e më tajare, e filloi të fliste. «Aman ore

ingliz, ama ore, në kini besuar perëndi, hidhuni një orë e më parë e bënani derman, se na e morën shpirtin komunistët!» «Oj më të hëngsha të témë!» thashë me vete «Po inglizit m'i thërret kështu, mor kulaku i mutit!» Ca isha i

mbushur nga tajarja e ca nga këto fjalë, e të më hipin xhindët, po qëtë hipuri, se. E t'i vajta e ta mbërtheva për gryke, e t'iu futa bamp... e bamp... e bamp...e. Ai filloj të përpeltej që të më shpëtonte nga duart. «Aman, o Rrapo, ç'po më bën kështu?» thërriste. «Ç'po të bëj kështu, thua? Po të sjell selamet e inglizit», i thashë dhe «po t'i sjell toptan!» dhe vazhdova bamp... e bamp... e bamp...e, derisa e zbraza inatin: (Pauzë:) E ja, kështu ndodhi. Ç'thoni ju, mos duhej t'i kisha rrahu krahët, meqë jam kryetar?! Jo, more!

LUFTARI — Krahët jo, por...

FATKA — Edhe kështu s'bën, o xha Rrapo!

RRAPOJA — Jo, more, s'bëka kështu, ë? Po gjaku i djemve tanë ku vete, po ardhì inglizi këtu, nuk më thua?

HYSKA — S'e lë njeri inglizin të vijë këtu, o xha Rrapo, jo.

RRAPOJA — S'e lë ti, po e ndjell ai, se. Ato fletushkat që hedh inglizi me tajare, Dauti me shokë i çojnë derë më derë. Mirë kur s'i shoh e s'kam ç'u bëj, po kur i shoh dhe i dëgjoj, aha, s'duroj dot më. Më hipën gjaku në kokë e s'përbahem dot, jo.

FATKA — Po ligji është ligj, ama.

RRAPOJA — Është, or, është ligj, por ai ligj është shkruar për armiqtë tanë e jo për ty e përmua. Oj, do të më dënuakan mua! E përsë,

ore? Sepse rräha një kulak, që duhej varur në porozhdën e gomarit tim. (*Të gjithë qeshin.*) Po pse, or vëllezër, po të kishte ligji gjak, e mish, e shpirt, siç kam unë, do ta duronte Dau-tin? Jo. Po edhe unë atë bëra, bre, se edhe unë jam njësh me ligjin tonë. Po kështu, o po si.

LUFTARI — (*I afrohet, i hedh dorën mbi supe dhe i jep një cigare.*) Na, merre!

RRAPOJA — Nuk e marr cigaren tënde, po qe në atë mendje, jo!

LUFTARI — Nuk jam më në atë mendje, jo. Jam me ty! Merre!

BESNIKU — (*Nga jashtë.*) O xha Rrapo!

RRAPOJA — Eja, brënda, o Beso! (*Hyn Besniku, xha Aliu dhe Nurka.*) Dhe lirohu një çikë, të keqen Rrapoja.

BESNIKU — Pse, me të liruar na qenka puna?! (*Qeshin e takohen.*)

LUFTARI — Mirë se erdhe, xha Ali!

ALIU — Mirëse ju gjeta, o bij!

LUFTARI — Po si më je, o xha Ali, me shëndet me kuvet?

ALIU — Me moshën që kam, gjynah të qahem.

RRAPOJA — Po pse, sa u bëre o Ali?

ALIU — I do pér rnofuskë, apo pér miuhabet, o Rrapo?

LUFTARI — Si të diuash zotrotë.

ALIU — Po ja aty të nëntëdhjetat po vete.

RRAPOJA — Po fi pësë vjet më parë i kishte mbushur të nëntëdhjetat, si kështu? Apo s'do të ngjitesh më tej?

ALIU — Jo, o Rrapo, jo, e kë gabim. Unë moshën e mbusha gjersa u çlinuam. Që andej e këtej kam filluar të zbrës e jo të shtoj, o Rrapo vëllai.

RRAPOJA — Hë më të lumtë, o Ali! Selvi, sillna dhe tre filxhanë, moj. E po ulu, Ali, ulu! Uluni, mor djema.

ALIU — E që thoni ju, more bij, ishte Besoja tek unë. Kuvenduam një copë herë dhe me të marrë vesh që kishe ardhur ti, more shoku Luftar, u ngrita e i thashë Besos do vi edhe unë me ty se dua t'i them diçka atij e juvë bashkë.

LUFTARI — Urdhéro e fol, xha Ali. Si i ke hallet?

ALIU — Halle s'kam unë, more bir, se hallet na e morën të keqen. Ishim pa tokë, Partia na dha tokë. Vërtet kemi ca vështirësi, po pse pak kishim edhe dje në luftë. Pastaj si dje s'jemi, de. Po duhet të jemi edhe më mirë. Domosdo që duhet të jemi më mirë dhe do të jemi. Edhe Partia këshfu thotë. Ajo thotë bashkoni tokat e krahët që të bëheni më të fortë. Edhe unë këshfu them. Ja pér këtë erdha! Shënoni dhe derën tonë, të Mukollarëve, në kooperativë.

LUFTARI — Të lumtë, xha Ali! (Të gjithë e miratojnë.) E, o Nurkë, e pe xha Alinë? Po ai xha Kasoja yt c'thotë?

NURKA — Më plasi, po s'merr të çarë gjékundi im atë, or shoku Luftar. Unë që vete e i flas botës, s'po i mbush dot mendjen tim eti. Pikë e zezë!

ALIU — Edhe unë i fola një ditë tyt eti, more bir. Atij dhe Telit bashkë. Aha, atyre u ziejnë mizat e Dautit në kokë.

RRAPOJA — Tamam në të i ke rënë, o Ali.

LUFTARI — Hë, more Beso, si venë punët. Shokët më thanë që punët venë mirë.

BESNIKU — Jo dhe keq, shoku Luftar, por duhet edhe më mirë.

LUFTARI — More, po me atë Rushitin c'ka ndodhur,

se është ankuar që e keni kërcënuar për të hyrë në kooperativë.

BESNIKU — Kërcënuar për të hyrë në kooperativë?

LUFTARI — Kështu thotë ai.

BESNIKU — Jo, bre, ne u kapëm me të për grumbullimet e jo për kooperativën. Ju e dini ç'po na kurdisin kulakët këtu në fshat. Ata shtyjnë fshatarët si Rushiti që të diskreditojnë politikën e re të grumbullimeve, e unë këtë s'e duroj dot, shoku Luftari.

LUFTARI — As ta durosh e as ta lejosh. Dhe jo vëtëm ti, po të gjithë ne.

BESNIKU — Oj, të duroj unë të më vijë Rushiti drejt e në zyrat e këshillit e aty të zërë e të më quravitet me fëmijët për dore. Hë, more Rrapo, fol, mor Hyskë, qe apo s'qe kështu? Zuri të thërriste në kupë të qiellit. Ne s'po e merrnim vesh ku e kishte hallin, kur ai ia pat: «Po të jap atë që kërkoni ju, unë ngelem me gisht në gojë, e këta fëmijë merrini dhe ushqejini ju, se unë s'kam me se!» E kush e thoshte këtë, ai që kishte brenda drithë për gjithë vitin. E po kjo s'durohet, de! (Kopsitet.)

LUFTARI — Po ti?

BESNIKU — Çfarë unë?

LUFTARI — Ai bërtit e ti bërtit, ë?

RRAPOJA — Lirohu të keqen Rrapoja!

BESNIKU — Lena, o xha Rrapo, tani.

RRAPOJA — Or po lirohu po të them!

BESNIKU — Ai është si Dauti, kulak e kaluar kulkut, paçka se nuk është shpallur i tillë.

RRAPOJA — Lëre Dautin ti, se ai është njëshi.

BESNIKU — Po ai edhe në punën e shkollës po na

ngatërron: S'i le që s'i le fëmijët e tij të vijnë në shkollë dhe i sorollat tërë ditën me dy kokë dhen.

LUFTARI — I kap detyrimi ata?

BESNIKU — Dy të vegjëlit i kap.

LUFTARI — Pse s'veprohet sipas ligjit? Kot e bëmë ne reformën arsimore të 46-ës. Asnjë lëshim.

BESNIKU — E ja kështu janë punët. E sa për ta fyier e kërcënuar, ja ku janë Rrapoja me Hyskën. Le të flasin në kam nxjerrë gjë të rëndë nga goja. Që u nxeha, u nxeha, Po. Zérin e ngrita. Këtë e pranoj. Mirëpo edhe ne humbasim ngandonjëherë, megjithëse s'kemi përse ta humbasim. Mirë po na venë punët kudo. Mirë jemi me grumbullimet, bile shumë mirë.

HYSKA — More, thoni ç'të doni, po ai Jani i grumbullimit qeni i punës është.

FATIKA — Qen, ore qen, po edhe llafe ka shumë.

HYSKA — E po at pa huqe s'ka de.

LUFTARI — Vazhdo Besnik.

BESNIKU — Edhe punët për ngritjen e kooperativës muk na shkojnë keq. Dy lagjet e lumi i kemi të dyja për kooperativën, përvèç Lames. Me një fjalë fshatarët e varfér i kemi pothuaj të gjithë me vete. Edhe shumë nga të mesmit po i tertiqim, por, siç jua thashë para një javë, kemi edhe vështirësira, vihemë në situata jo të mira dhe të gjitha këto dihet kush ma i kurdis. Ata na i goroditin një takëm fshatarësh që të vijnë pastaj e ta bëjnë, siç na e bëri Rushiti. E ja këtu e humbim ngandonjëherë durimin, shoku Luftar, se edhe ne prej gjaku jemi.

LUFTARI — E po këtu ta kam fjalën edhe unë, o Besnik. S'duhet humbur durimi, se po hum-

bëm durimin, njerëz si Rushiti, që s'shohin më téj se hunda e tyre dhe që kanë patur pësinë të gënjejnë pér të mos glyer detyrimet, kalojnë fare matanë. Po a ná intereson ne kjo, më shokë? Jo! Nuk na intereson.

RRAPOJA — U pa kjo punë, o Beso. E paskeni shkelur një çikë me atë të bërtituren.

BESNIKU — Do ta ulim paskëtaj, o xha Rrapo.

LUFTARI — Mirë, mirë, veç mos harroni se kolektivizimin e bujqësisë nuk kemi ndër mend ta bëjmë as me ligj, as me forcë, po me bindje dhe me vullnetarizëm dhe njerëzit nuk binden me një fjalë, por me punë të gjatë, të durueshme dhe këmbëngulëse.

RRAPOJA — Po kur s'u mbushët koka?

LUFTARI — Kokët duhet të dish t'i mbushësh, xha Rrapo. More, po ja ta marrim shtruar: ç'dinë një takëm pishanjakësh pér kooperativën? Ca fjalë të thata, që një takëm i kanë mësuar përmendësh dhe venë e i thonë kudo e me këdë. Fshatari ynë është i vojtur, i regjur ngajeta. Ai po s'i pa dhe po s'i preku gjérat me dorë s'para bindet. A e kemi marrë ne atë Lamen, apo tjetrin e të shkojmë në Luadhas, në kooperativën më të mirë të rrëthit tonë, që t'i shohë me sytë e tij të mirat e kooperativës. E kemi bërë ne këtë? Jo. Po pse kështu do t'i shtojmë kooperativat? Jo, shokë! Kështu s'kemi gjë në torbë. Po nuk arritëm t'i hyjmë në shpir fshatarit e t'ia njohim të gjitha të fshehtat e tij, nuk do të dimë ta bindim e t'a bëjmë pér vete. Mos ju duket e lehtë ta shikëpusni fshatarin nga ajo pak tokë e gjë që ka? Mos kujtoni se

bëhet pa dhëmbje kjo? Pa ta nçgulim gjilpërën
në gjurin tonë, dhëmb apo s'dhëmb?

RRAPOJA — Oj të dhembur, se!

LUFTARI — Prandaj të mos e ngatérrojmë kurrë,
shokë, qëndrimin e fshatarit ndaj kooperativës
me qëndrimin e tij ndaj Partisë. Ai ka qenë e
do të mbetet me Partinë, i lidhur si mishi me
thoin me të. Por ai ka ca hesape për të larë
me ato që i ka lënë e kaluara në shpirt. E kam
fjalën për shpirtin e pronës. E po ja pikërisht
këtu duhet përqëndruar puna jonë që ta ndih-
mojmë atë që ta bëjë këtë shkëputje.

BESNIKU — E po ja këtu ngecim, shoku Luftar.

LUFTARI — Këtu e kemi të vështirë, deshe të tho-
she? Domosdo, pasi veg atyre që trashëgon e
i ka në gjak fshatari ynë, këtu gjen terren edhe
armiku për të punuar.

BESNIKU — Ja këtu desha të dilja edhe unë, shoku
Luftar.

LUFTARI — Po. Pa hë!

BESNIKU — Pa ta shohim një herë, pse s'po e shti-
em akoma në dorë atë bandë, që na fanepset
herë pas here, në kënetë e që po kryen vepra
sabotazhi dhe terrori?

HYSKA — Masha e gjithë kësaj dore të ndyrë, ajo
bandë është.

BESNIKU — Mirëpo e keqja është se s'po e shtiem
që s'po e shtiem dot në dorë. Ne i ngrejmë
kurthi këtu, ajo na fanepset në një vend tje-
të; ne rretho këtej, ajo dil andej.

PIRROJA — Ne ruaj Pishën, ajo na del në Gorricë.

RRAPOJA — Ka kallauz ajo bandë, djema!

HYSKA — Pa derman, ndryshe do ta kishte ngrënë
kokën me kohë.

LUF'TARI — Edhe kështu do ta hajë se s'bën, vegse duhen hapur sytë më tepër, shumë më tepër.
Apo jo, xha Rrapo?

(*Hyn e del Selvija për të tretën herë. Rrapoja s'përbahet.*)

RRAPOJA — Moj, po ti q'ke që hym e del kështu, ë?
SELVIJA — E po shih punën ti tani, de, se, kemi edhe ne hallet tonë.

ALIU — E po lëviz edhe ti, de. Kushedi si e ka hallin.
(*Rrapoja del jashtë te Selvija.*)

RRAPOJA — Na, moj, këtu. Për ç'hall e ke fjalën ti, ë?

SELVIJA — E po m'u vonua Shega, de. E kam dërguar për te teto Polja e s'po duket.

RRAPOJA — (*Tronditet.*) Teto Polja, the? Ja! Gjer këtu erdhi puna-a? Hë më ju kripsha kokën të dyjave, që s'më dëgjuat një herë. (*Vijnë me vrap Shega dhe teto Polja.*)

TETO POLJA — (*Flet me vete.*) Ja, ja, nuse e nënës, Erdha, Erdha të keqen.

RRAPOJA — (*I del përpara.*) Po hë, moj e uruar, q'u bëre?

TETO POLJA — Pika, Selvi! Po ç'e paske humbur kaq, moj e uruar, që më le për sahatin e fundit?

SELVIJA — E humba, Pole motër, e humba. Pastaj sikur më erdhi një çikë papritur.

RRAPOJA — Shiko t'i! Hap sytë nusen, se pastaj të mos më dalësh përpara!

TETO POLJA — U piika! Se mos e kam Lulen për hatrin tënd.

RRAPOJA — Moj, po hap sytë, po të them!

TETO POLJA — Unë që prita Asimin tënd, unë do të ta pres edhe nipgen.

RRAPOJA — Hënde, të lumtë ajo gojë!

TETO POLJA — Pa dilni jashtë tani, atë bëni! Hë, o burra!

LUFTARI — Po na përzë nipçja, o Rrapo, (*Ngrihet.*)

RRAPOJA — (*Teto Poles.*) S'kemi ku vemi ne, jo, se bën ftohtë. Ju shihni punën tuaj. (*Polja largo-het e ai Luftarit.*) Ulu, ulu, o Luftar!

LUFTARI — Do shkojmë me Besnikun në Gorrice. Do të mbledhim komunistët për të gjitha këto që biseduam këtu.

RRAPOJA — (*I hutuar.*) E po dale, de!... Po uluni, de... Mor Pirro, po mbushua, mor i uruar, nga një gotë. (*Pirroja mbush gotat.*)

LUFTARI — (*Duke u ulur.*) E po, ç'thua, o Besnik, presim edhe pak për hatër të xha Rrapos.

BESNIKU — Presim, shoku Luftar. (*Hyn Selvija e diç merr në sepet.*)

RRAPOJA — (*Nervoz dhe i trembur.*) Po për tani i paske lënë të gjitha, moj lanete?

SELVIJA — As na lë rehat tani, se na çmende. (*Del.*)

RRAPOJA — Hë, pikë e zezë! Ke parë ti kështu? (*Luftarit.*) Më vajti goja këtu, mor Luftar, së thëni ruani nusen, Selvi! (*E përqesh.*) «S'kam ç'i bëj, vetë ajo s'rri rehat. S'janë të rënda, më thotë» s'janë të rënda, po...

FATKA — E po dale, o Rrapo, de, se Selvija ta lindi Shegën në arë e s'e gjeti gjë.

RRAPOJA — Lëre Selvinë ti, se është tjetër brumë ajo.

HYSKA — E po edhe kjo bijë e Selvisë është, o Rrapo.

RRAPOJA — Tjetër kohë ishte atëherë, o Hyskë. Nga halli. (*Rrapoja ngrihet dhe vete te dera,*

ku përplaset me Shegën.) Të plasën kështu,
Ha?... Thyej qafën matanë!

SHEGA — Sa të marr diçka, baba. (*Merr diçka në se-
pet dhe largojet, Rrapoja e ndal te dera.*)

RRAPOJA — Hë, moj, si i ka punët? (*Shega e turpë-
ruar heziton.*) Fol moj, po të them!

SHEGA — (*E turpëruar.*) Po ku di unë, mor baba!

RRAPOJA — Kujdes nusen, o të zeza, se pastaj të
mos më diilni përpëra! (*Shega largojet e ai
kthehet në vend.*) Mos ma vini re, ore djema,
se ë kam mendjen të ngritur fare.

ALIU — Sipas zemrës ka për të ta dhënë, o Rrapo.

LUFTARI — Për të mirë ka për të dalë, dëgjo Luf-
tarin ti. (*Ndihet klithma e foshnjës së porsa-
lindur.*) Të na rrojë, xha Rrapo!

TË GJITHË — Të na rrojë e me jetë të gjatë, o xha
Rrapo.

RRAPOJA — (*I gëzuar dhe i hutuar.*) E po daleni,
de! Të na rrojë, të na rrojë! Pritni një herë ta
marrim vesh, oj! Fol, moj!

SELVIJA — (*Nga brenda.*) Djalë! Djalë! Djalë!

TË GJITHË — Djalë, xha Rrapo!

RRAPOJA — (*Tepër i emocionuar.*) Më rrofsh, moj
nuse, që ma ngjallë prapë Hysninë! (*Përlotet.*)
Mirë se më erdhe, o biri i babait! E kishte zënë
madli babanë për ty, o bir!

LUFTARI — (*I vete pranë.*) Mbaju, xha Rrapo! Unë
të dija shkëmb.

RRAPOJA — Shkëmb jam në lidhërimë, o bir, po
gëzimi e thyen lehtë Rrapon. (*E mbledh veten.*)
Ja, u mbajta.

LUFTARI — Tani, besoj, do të na japësh leje të
ikim?

RRAPOJA — (*I hutuar.*) Lejë, the? Po mirë, mor bir.

(*Ngrihen të gjithë e ai kujtohet.*) Mor po dale, se e humba të shkretën. Po pse, o vellezër, nuk do ta pimë shëndetin e nipçes? Hë, o Pirro, na e mbush edhe nga një! (*Pirroja i mbush gotat.*) LUFTARI — Shëndeti i nipçes, xha Rrapo! Të na rrojë! (*Të gjithë pijnë dhe urojnë.*) Ai erdhi në kohë të mira, xha Rrapo, dhe kohëra më të mira e presin!

S I P A R I

Shëndeti i mirë, qëndroj, qëndroj, qëndroj,
Nëpër gjithë shtëpi, qëndroj, qëndroj, qëndroj,

Shëndeti i mirë, qëndroj, qëndroj, qëndroj,
Nëpër gjithë shtëpi, qëndroj, qëndroj, qëndroj,
Shëndeti i mirë, qëndroj, qëndroj, qëndroj,
Nëpër gjithë shtëpi, qëndroj, qëndroj, qëndroj,

Shëndeti i mirë, qëndroj, qëndroj, qëndroj,
Nëpër gjithë shtëpi, qëndroj, qëndroj, qëndroj,
Shëndeti i mirë, qëndroj, qëndroj, qëndroj,
Nëpër gjithë shtëpi, qëndroj, qëndroj, qëndroj,

A K T I II

Porsa hapet perdja, Sanija dhe mjeku janë te Bektashi. Prej andej dalin dhe vijnë e ulen te tavolina.

SANIJA — Mua folmë hapur, doktor!

MJEKU — Që rëndë, rëndë shumë është, Sanije hanëm. Përveç paralizës ai ka edhe një arteriosklerozë të trurit shumë të avancuar.

SANIJA — E pastaj si?!

MJEKU — Si t'ju them, Sanije hanëm. Por, meqë m'u lutët t'ju flas hapur, më vjen keq, po s'e ka të gjatë. Duhet të pregatiteni.

SANIJA — E zeza unë....,

MJEKU — Bëjuni e fortë. S'ke ç'i bën. Ka edhe një fund. (*Nxjerr nga xhepi një paketë ilaçesh.*) Këtu kini një përzierje ilaçesh. Janë pér ta qetesuar, d.m.th. pér t'ia qetesuar gojën, meqë thotë gjëra me zarar. Do t'i jepni vetëm tri paketa. Kujdes, se gjashtë, paketa e vënë në gjumë e s'e ngrejnë më! Kaq pér sonbe. Më falni se ngutem. Ika. Natën e mirë!

SANIJA — Natën e mirë dhe të falemnderit doktor!
(*Mjeku del, hyn Nurija.*) Po ti, akoma s'paske
fjetur, moj?!

NURIJA — Jam akull e tëra. Erdha të marr një të
ngrohur. (*Ulet.*) Ç'tha doktori?

SANIJA — Rëndë, shumë rëndë. Punë me sot me ne-
sër është.

NURIJA — Të zezat ne që do të mbetemi si dy qyqe
në këtë copë të kësaj gërmadhe që na kanë lë-
në.

SANIJA — Në na e lënçin edhe këtë copë.

NURIJA — Mirë thua, në na e lënçin.

BEKTASHI — (*Nga vendi rënkon.*) Uf! Uf! Plasa,
plasa! Hiqmani një jorgan!

NURIJA — Unë s'ndjej të ngrohur gjékundi, kurse
ky më thotë plasa. S'ndjej të ngrohur gjékun-
di, Sano, akull jam, akull.

SANIJA — Akull motër, akull. Lagështia e këtyre
mureve na e ka kallur të fitohtën në trup dhe
në shpirt.

NURIJA — Mirë thua. E nga do ta gjejmë të ngroh-
tët me të gjitha këto që po na bëjnë këta. Dje
Reformën Agrare, tatimet, kulakillëkun, sot
kooperativat, nesër kushedi ç'u pjell mendja
dhe, në fund, një zot e di se ç'mund të na bëj-
në.

SANIJA — Mjerë ne, thuaj. Ata matanë në na bëf-
shin derman.

NURIJA — Ata matanë, the?! Aha...! Ku i ke? Gjë-
kundi! Mirë thoshte vjehrri yt». Ai që s'mbron
dot mallë e gjënë, ai s'mbron dot as vetën».

SANIJA — Mirë thoshte vërtet, por vjehrri im, s'i
njohu komunistët, se. Ç'do të bënte ai po të qe

gjallë? Hiç. Me sa po bëjmë ne, që na i morën mall e gjë e shtëpi e katandi e ç'patëm e ç'nuk patëm dhe na përplasën këtu ku jemi, për ibret.

BEKTASHI — Mos i besoni Janit! Ai tërë jetën kan grënë në kandar. Atë punë bën edhe sot. Uf!

Uf! Plasa, plasa! Hiqmani një jorgan!

SANIJA — Shko hiqja një batanije.

NURIJA — Sa para bën. Prapë do ta kërkojë t'ia hedhim.

SANIJA — S'kemi ç'bëjmë. Na zuri.

NURIJA — Atë thuaj, na zuri. (*Shkon te shtrati i Bektashit i heq batanijen.*)

SANIJA — Mora vesh se Fatkën e paskan vënë në këshill dhe zyrat e këshillit duan t'i ngrejnë këtu pranë nesh, te shtëpitë e Demir beut, më duket. (*E motra s'përgjigjet.*) Erdhi që erdhi pranë nesh. (*Pauzë.*) Para se të niste lufta e kishe tërë ditën këtu Ishte gati të bëhej copë, mjafton që të ishte pranë teje, Nurije.

NURIJA — E ku të vente, moj? Këtu i thoshte Bektashi, këtu punonte dhe ai. Mos kishte hallin tim, që rrinte e rropatej tek ne? Jo, moj e zezë, jo, po kishte hall buke dhe për atë krohdhë buke rropatej.

SANIJA — Po edhe ty ama, s't'i ndante sytë. S'është djalë i keq, Nurije.

NURIJA — Përse m'i thua këto?

SANIJA — E po ti...

NURIJA — E di ç'do të thuash, po s'bëhet ajo. Pse, moj, kaq poshtë paskam rënë unë, sa të katan-dis në duart e hyzmeqarëve të mi, si Fatka me shokë?!

SANIJA — Budallaçkë! Mendohu një herë, mendohu, pastaj prit. Na duhen njerëz si Fatka, ndryshe na mori lumi.

NURIJA — Kësaj i thonë «varu motër ti, se mua më merren mendtë». S'bëhet ajo.

SANIJA — Bëhet, bëhet, po mendohu.

NURIJA — S'kam përse të mendohem. (*Pauzë*) Pastaj boll e kemi Janin. S'është i paktë dhe ai.

SANIJA — Janin the?! Mos e var atë shpresë tek ai.

NURIJA — Jo po thashë, de, se atë e kanë bërë goxha llogaritar në qendrën e grumbullimit. Domethënë që e ka mirë me këta.

SANIJA — E ka mirë me këta!? Akoma s'e dimë.

NURIJA — Si akoma s'e dimë?

SANIJA — Sepse ai ditit e ua fshehu bëmat e tij. Rrah hu gjoksin se kishte ndihmuar gjatë Luftës. Filloj të thërriste «Rroftë Pushteti! Urra përparral», po mos kujto se këta i hanë kollaj këto. Ka patur dhe të tjerë si Jani, por... Fatkën, Fatkën shiko ti! Lëre Janin. (*Hyn Piloja me dy kërcunj, që i vë në zjarr*.) A ke të ftohtë, mor Pilo?

PILOJA — Po edhe kam, moj zonjë. Pleqëri hesapi.

SANIJA — Ulu, ulu merr një avull. (*Piloja ulet*.)

NURIJA — Ç'të thanë në këshill, ë?

PILOJA — Duan që të hiqem edhe unë mënjanë.

SANIJA — Po kush ngul këmbë kështu, Fatka?

PILOJA — Fatka është një gojë, moj zonjë, e një gojë imbyllët, po ç't'u bësh të tjerëve, se. «Duhet të hiqesh mënjanë edhe ti», më thonë.

NURIJA — E ku të vesh, o i zi?

PILOJA — E ku të vete, de? Edhe unë atë u thashë, po ata seç më ngatërrojnë me ca fjalë: «jo sot je zot i vetes» më thanë, «jo mjaft punove përtë tjerët!». Mor po ku e keni hallin ju, i pyeta unë. Që të iki nga Bektash beu? S'bëhet ajo, u thashë. Unë atje u rrita, atje kalova jetën, atje dua të mbyll dhe sytë.

NURIJA — (*Kureshtare.*) Po ata ç'të thanë, kur u the këto?

PILOJA — Avazet e tyre, Ata me të tyren, unë me timen dhe kështu kemi mbetur. (*Ngrihet.*) Po iki të çaj edhe nja dy krahë dru, se do t'ju duhen sonte.

BEKTASHL — (*Nga vendi.*) Sa të gënjeshtra ka kjo dynja. Thonë për shembull se kur pi ujë, as gjarpëri nuk të trazon! Gënjejnë! Gënjejnë për perëndi! Atë partizanin ne e vramë tamam tek burimi kur po pinte ujë.

SANIJA — (*E trembur nga prania e Pilos.*) E ç'nuk thotë i zi, more Pilo. Të qëna dhe të paqëna. E ka humbur fare. Mës ia vër veshin, se e ka sëmundjen të tillë. Kështu tha edhe doktori.

PILOJA — Jo, moj zonjë, jo. Mos ki merak, se s'del gjë nga Piloja. Më ka mësuar i ndjeri yt atë që të mos kem as veshë, as gojë.

SANIJA — Atë më thoshte edhe mua, ndjesë pastë. Pilon e dua, Sano, se është pa veshë e pa gojë. Dhe ashtu duhet të jetë njeriu.

PILOJA — Piloja është njeri pa njeri, moj zonjë. Ju ve ju ka. Këtu u rrita dhe këtu dua të vdes, por ama, me nder, zonjë, me nder.

SANIJA — Hallall bukën, Pilo! Ashtu duhet, me nder.

PILOJA — Dhe sot më ka ardhur tamam koha që edhe unë ta mbyll me nder. (*Pauzë.*) Kishit gjë tjetër për mua?

SANIJA — Shko e fili, se je i lodhur. Sonte do ta ruaj vetë Baktashin, se s'është hiç mirë.

PILOJA — Si të urdhërosh, zotrote, veç mos më kurse. (*Del.*)

NURIJA — Sepse ia kam frikën këtij njeriu.

SANIJA — Për Pilon e ke fjalën, moj?

NURIJA — Për Pilon, për Pilon. Nuk e marr vesh, që kur kanë hyrë këta, në vend që t'i ngrinte veshët, i ka ulur edhe ca më shumë. Kësaj s'po i jap dot dum

SANIJA — Mos i bjer më qafë të ziut, se është njeri pa njeri, Ne na ka.

NURIJA — Ne, moj, ne dhe për ne ka të grumbulluar mërinë e një jete të tërë vuajtjesh dhe mjerimesh që ka hequr në këtë derë. Nuk e dëgjove si tha: «sot ka ardhur tamam koha që edhe unë ta mbyll me nder!»

SANIJA — Nuk ka dhëmbë Piloja për të të kafshuar, jo.

NURIJA — Po ka gjuhë nepërke për të helmuar, se.

BEKTASHI — (*Nga vendi.*) Po qe se sonte është e premte, aherë sonte është fundi im. Komunistët do të vijnë të më arrestojnë: «Ti je Bektash bej Mollasi?» Si urdhëroni, unë jam. «Je i arrestuar!». Po pse, xhanëm? Ç'kam bërë unë i ziu?» Ç'ke bërë ti? Se mos ke bërë vetëm një gjë. Ti me Demir benë vratë atë partizanin tek kroi dhe denoncuat atë tjetrim e plagosur, që strehohet në fshatin tuaj. Edhe në kohën e Reformës bëtë qmos të na sabotonit dhe na vratë shokët. Me Janin, Dautin dhe me tët shoqë, keni ngritur grupin e 'kulakëve. Tani të pret edhe ty plumbi!» (*Thérret.*) Mos, mos, mos! Mua më shtynë, më shtynë të tjerët. Do t'jua tregoj të gjitha, veç falmëni jetën.

SANIJA — (*Mënjanë.*) Në paç më gojë, tregojua.

NURIJA — Si the, si the?!

SANIJA — Më vjen këq për të zinë, o Nuriye, se s'ekan të gjatë, më duket.

NURIJA — Mjerë ne, që do të mbetemi si dy qyqet në këtë gërmadhë.

SANIJA — Ai atë rrugë ka zënë, o motër, veçse edhe kështu s'durohet, de. Do të na marrë më qafë të gjithëve. Sa për këtë gërmadhë në na e lënçin thuaj. Ej, virane jetë. (*Pauzë.*) Ngjitu, ngjitu lart fli, se kushedi se si na vijnë punët nësër.

NURIJA — (*Duke u ngritur.*) Mirë thua. Po iki. Natën e mirë! (*Largohet.*)

BEKTASHI — (*Nga vendi.*) Thonë se bushrat kafshojnë më hidhur, kûr kërkojnë derman.

SANIJA — (*Nga vendi.*) E the një herë këtë, Bektash.

BEKTASHI — Bushrat shkojnë me këdo, po s'duan asnjë, as babanë e këlyshëve të tyre.

SANIJA — S'bëjnë dot qentë pa bushrat, jo. (*Pauzë e gjatë.*) Po ky ç'u bë? Pse u vonua kaq!

BEKTASHI — Djalli është mië i sertë, kur futet në zemrën e gruas.

SANIJA — Mbështetur të drejtë, o i zi.

BEKTASHI — Dhe gruaja e bukur qëdo natë mbarset me djallin.

SANIJA — Se bukurinë të gjithë e lakmojnë dhe e ngacmojnë, Bektash.

BEKTASHI — Dhe kur ai e shtyn atë që të vrasë burrin, atëherë botës i ka ardhur fundi.

SANIJA — Mund të jetë edhe kështu. (*Ngadalë hapet dera dhe hyn Jani.*) Ç'u bëre?

JANI — Sht! Flejnë të gjithë?

SANIJA — Flejnë, flejnë, po afrohu. Vetëm je?

JANI — (*Vjen pranë Sanijes.*) Erdha me «Veshin». Jashtë është. Po ruan. Erdhi doktori?

SANIJA — Erdhi.

JANI — E ç'tha?

SANIJA — Më dha një ilaç që e kishte pregetitur vetë. Me gjashtë paketa bie në gjumë e s'ngrihet më.

JANI — Që sonte.

SANIJA — (E trondititur.) Sikur ta shtynim edhe c' dite?

JANI — Sa t'i thotë të gjitha, ë?! Po qe kështu, po vete vetë, me këmbët e mia te komunistët, që të denoncoj veten dhe ju. Rrugë tjetër s'ka.

SANIJA — E mjera unë!

JANI — Kam një letër me rëndësi nga «Babai».

SANIJA — Po ajo mbledhje e fshatit ç'ishte, se sa herë që mblidhen ata, do të bjerë ndonjë kambanë e zezë për ne?

JANI — U mblodhën për punët e kooperativës.

SANIJA — Mos kanë rënë gjë edhe në gjurmët to-na?

JANI — Ende vijnë rrötull, por duhet të ruhemi shumë.

SANIJA — Deri këtu paskan ardhur punët, a? Mjerrë ne!

JANI — Sa të kemi «Veshin», s'na gjen gjë, jo.

SANIJA — (Kureshtare.) Pa ma lexo letrën e «Baqait», ç'hotë ai.

JANI — (Nxjerr letrën dhe lexon.)

«I dashur «Bakkall»!

Me «Veshin» porsa i biseduam ato që paskan ndodhur aty në Pishë, për fajin tuaj. Ne, «Bakkall», duhet të ecim pa lënë gjurmë, ndryshe ramë në duart e sigurimit dhe morëm fund».

SANIJA — Përse e ka fjalën?

JANI — Për atë ankesën që kurdisëm edhe për Besnikun.

SANIJA — Të thashë unë, po ti s'më dëgjove.

JANI — Dëgjo, dëgjo. (*Lexon*):

«Fshtarët që kini bërë për vete duhet të lëvizin më tepër. Ata janë dora jonë për të penguar kolektivizimin. I mëkoni më mirë, më me mend dhe i ndërseni të përleshën me fshatarët që duan kooperativën. Të gjithë sa jini, duhet të mos u zërë as gjumi i natës për punën e kooperativës, pasi ngritja e tyre është grusht, në mos vdekje për ne».

SANIJA — Mirë thotë.

JANI — Mirë thotë, po ec e çaj, se Urdhëra japim të gjithë, po pa ec e provoje një herë, pa ta shohësh.

SANIJA — E po...

JANI — Ç'e po, moj?! Kemi mbetur me dy tre fshatarë dhe ata një përplasje duan dhe e kthejnë fletën. Lena për kokën tënde!

SANIJA — Burracak!

JANI — Nuk jam nga ata unë që ngopen me lugë të zbruzur, jo.

SANIJA — Po atëherë pse më mburreshe deri dje këtu, ë? Apo që të më zhvatje ato që të duhen, ë?

JANI — Mend do të më japësh tani? Nuk e sheh, moj e zezë, se si na e kanë ngushtuar lakun pas qafe. Ata s'i zë gjumi as ditë, as natë duke na përgjuar ne. Dhe ti e di që këta nuhasin shumë.

SANIJA — Domethënë ti thua...

JANI — Lëre ç'them unë, por edhe ato që thonë ata, që janë në krye tonë, s'bëhen, jo. E dinë se

është fushë me lule ata këtu dhe harrojnë se ky vend pëllëmbë për pëllëmbë na përgjon e mban erë barut. Ja, kështu!

SANIJA — Mor po ç'paske ti kështu sonte, ë?

JANI — U lodha, moj, u vela me ato premtimet e tyre. Kemi kaq vjet që vetëm presim dhe asgjë s'po bëhet. Dëgjo, dëgjo. (*Lexon*) «Nga marsi pritet të vijë një mik nga kurbeti. E dërgon Aldoja yt»...

SANIJA — Ç'është ky Aldo, more?

JANI — Një miku im, që jam lidhur kur isha në Itali.

SANIJA — E po, e sheh që miqtë s'na kanë harruar?

JANI — E moj, e. Miqtë s'vijnë për të na i hequr kularin, jo, po për të na e rënduar dhe ca samarin. E pastaj, ec e mbaje atë barrë. Dëgjo, dëgjo. (*Lexon*): «Farefisi mjaft u fsheh këne-tave. Ka ardhur koha që dora e tij të godasë dhe sa më mirë të godasë, aq më mirë e bën frika punën e saj».

SANIJA — Mirë thotë. Duhen qëruar sa më parë ata që na i ngatërrojnë këmbët, si Besniku, Rrapoja më shokë.

JANI — Pse s'thua që nga Luftari, që s'po e marrim vesh ku e ka zyrën, në qytet apo këtu në fshatrat e Rrëzës?

SANIJA — Vazhdo!

JANI — (*Lexon*.) Ju urojmë për djegien e depos!

SANIJA — Hë!

JANI — Ju falemi nderit!

SANIJA — Vazhdo!

JANI — Vazhdoj unë. (*Lexon*.) Hanëmi të kujdeset për ta qetësuar sa më shpejt të «sëmurin me huqe».

JANI — (Duke palosur letrën.) Ja, kjo ishte letra!

(Ajo zgjat dorën ta marrë, ai e djeg.)

SANIJA — (E hutuar.) Po ti q'mendon?

JANI — Bektash benë që sonte!

SANIJA — Atë e ka vrarë zoti! E mjera unë!

JANI — I mjeri ai, thuaj!

SANIJA — Të mjerët ne!

JANI — Si, the?

SANIJA — I mjeri ai, thashë.

JANI — Zoti e ndjeftë!

SANIJA — Amin! (Pauzë e gjatë.) Po për «Farefisin» ç'ke menduar?

JANI — Atë që kanë urdhëruar.

SANIJA — E si, demek?

JANI — Disa prej tyre t'i sjellim këtu.

SANIJA — Këtu? Ku këtu?

JANI — Këtu, tek ty.

SANIJA — (Zmbrapset e trembur.) Bah! Je në vete?! Edhe ajo më duhet.

JANI — Do t'i vendosim në bodrum, atje ku më çove mua për të parën herë. Të kujtohet?

SANIJA — (Rrëmbyeshëm.) Më kujtohet, më kujtohet, po s'bëhet ajo.

JANI — Atëherë të heqim dorë nga lufta?

SANIJA — S'thashë të heqim dorë.

JANI — E po lufta me frikë s'bëhet, de.

SANIJA — Po, trimëria do edhe mençurinë pas.

JANI — Me ato mënd që kemi do t'i mendojmë të gjitha

SANIJA — Mua folmë më shkoqur, se kështu s'më ngroh dot, jo.

JANI — Dëgjo këtu. Dyshimi i këtyre për «Farefisin» vjen vërdallë dhe përgjon tej nga këneta, nga

Baltëza e jo këtu mu nën hundët e tyre. Pastaj «Veshi» përgjon e s'na lë të biem në kurth.

SANIJA — Bëj si të duash, veç me mend.

JANI — Lema mua, pa di unë. (Pauzë.) Me Nurijen bisedove pér Fatkën?

SANIJA — Punë e ftohtë më duket, Jani. Erdhi sot, thirri Pilon në këshill. I foli e gjora, por ai s'i hodhi as sytë, përkundrazi diç pashë në sytë e tij, o Jani, diç e ftohtë, e hidhur e kalbur, që vërvitej mbi ne të dyja.

JANI — Urrejtja e tij pér ju, pér ne të gjithë është ajo që ke parë ti. E, ja, këtë urrejtje ne duhet ta zbutim, ta zbutim, Sano, se kjo na i hap të gjitha rrugët. Na duhet Fatka, Sano!

BEKTASHI — Sano! Vetëm je, moj?

SANIJA — Vetëm jam, vetëm. (Kujtohet.) Pilon do ta mbaj, Jani, se më duhet. E kam edhe dorë edhe perde.

JANI — Bëj si të duash. Ti e njeh më mirë.

BEKTASHI — Kur të vijë ai kodoshi, ma dërgoni këtu, se dua t'i them nja dy fjalë. Ti mbylle, se s'di gjë!

JANI — Ç'thotë, moj?

SANIJA — Ty të kërkon.

JANI — Tutkuni!...

SANIJA — Prandaj i lëpiheshe gjer dje?!

BEKTASHI-Ai kodosh ka dy fytyra. Vetëm unë ia njoh të dyja. Estakfurullah! Ta bën dobiçin e të thotë «na, mbaje!»

JANI — Lena, o Bektash, pér kokën tënde! (Sheh orën.) Ika, Sano. Ika se u bëra vonë.

BEKTASHI — (Nga vendi thërret:) Unë nuk kam para, zotërinj. Pér atë perëndi, nuk kam! Mua Asllan beu më mori dhëndër brënda pér të bi-

jën, Sanijen. Mallin dhe paratë i ka ajo. Asaj kërkojani!

SANIJA — Ashtu është Bektash, veç ti s'e di, o i zi, se atje ku ka gojë, ka edhe veshë. Unië veshët e botës as i shoh, as i zë dot, prandaj kam vendosur të mbyll gojët tona. (*Pauzë. Shkon te Bektashi. Pas pak del andej e lodhur, me flokët e prishur.*) Natën e mirë edhe zoti të ndjetë, Bektash (*Errësim sipar.*)

AKTI I TRETË

Shtëpi fshati. Shtëpia e Kasos. Në dhomë, ulur në minder, Nurka diç lexon. Nga jashë vjen një vërvshëllimë.

NURKA — Kush je ti, more? (*Hyn Pirroja.*) Po ku je, o t'u mbylltë? Nga na ke humbur kështu?
PIRROJA — Ashtu i kam patur punët. (*Pauzë.*) Hë, ç'kemi këtej nga fshati?

NURKA — Mirë, mirë jemi. Ja, po vazhdojmë shtëpi më shtëpi: Besniku me Rrapon mënjanë, Fatka me ca shokë në anën tjetër. Gjer mbrëmë dhanë fjalën edhe 10 shtëpi të tjera. Së shpejti mendohet të mblidhet fshati.

PIRROJA — Po andej nga të kam thënë ç'kemi ndonjë të re?

NURKA — More Pirro, a e di ti që edhe me fëmijët e Rushitit, edhe me ata të Dardhës, po i njëjti njeri na i turbullon ujërat. Dhe punë e hollë shumë. Atyre të Dardhës u thotë: «Bëni si të bëni këtë vit e mos i çoni, se mot u vjen shkolla në fshat», kurse këtyre të fshatit, Rushitit me shokë, u thotë: çoni or fëmijët me ba-

gëti e vetë merruni me tokën, që të lani detyrimet».

PIRROJA — E hollë qënka, pér besë, tamam pér mendjen e Janit.

NURKA — T'ëmën të qëlluar që i bëre, o t'u mbylltë! Ai është!

PIRROJA — Të thashë unë, mos iu ndaj, Nurkë. Ti i kuption këto punë mirë, po pa gjë s'është ai, jo. Kam edhe ca shënja të tjera.

NURKA — Ia ke thënë Besnikut?

PIRROJA — Ato që duhen, ia kam thënë. Po xha Kasoja, ç'thotë?

NURKA — Aha! S'merr të çarë gjëkundi im atë, or vëlla! Se si do t'ia bëj me të, as unë s'e di. Pér besë, or ti Pirro, po s'u bind edhe këtë herë u ndava me të e do të hyj vetë në kooperativë. Nuk e honeps dot unë shtëpinë tonë jashtë koooperativës, vëlla, jo.

PIRROJA — S'kanë pér të vajtur punët gjer aty, jo. (*Pauzë.*) Nurkë, e di si e kam hallin? Unë ngutem, se ashtu e kam një punë, po ti, po deshe, bëmë një nder.

NURKA — Fol, mo, si e kë hallin?

PIRROJA — Hidhu shpejt gjer te xha Rrapoja dhe jepja Besnikut këtë letër. (*Ia jep letrën.*) Na, na! (*Ia merr letrën dhe shton diçka.*) Merre dhe nisù. (*Nurka niset.*) Dëgjo, po e pe Shegën, bëji të fala, po mos i thuaj ku jam. Nisu!

NURKA — Fjalë është ajo? Ja, ika. (*Ai ikën, ndërsa Pirroja merr e lexon librin. Hyn Kasoja.*)

KASOJA — (*Që e sheh Pirron.*) He! Nga vajti ai birboja im?

PIRROJA — E çova unë gjer në një vend.

KASOJA — Hë! Me demek kini edhe ju ca punëra kësht u,ë? Shikoni se...

PIRROJA — S'bëjmë punëra me zarar ne, o xha Kaso, jo.

KASOJA — E po thashë, de, se çoc e kini marrë një çikë përpjetë edhe atë punën e kooperativës.

PIRROJA — Gjersa është për të mirën tonë, ne për të jemi.

KASOJA — Për të mirën tonë, the? S'ka ku të vejë më mirë se sa jemi. Vetëm të na lënë rehat. Ne s'po u kërkojmë gjë.

PIRROJA — S'është ashtu, o xha, Kaso, jo.

KASOJA — E po domosdo që për ju të rinjtë s'është ashtu, sepse ju s'ka ç't'ju dhëmbë, po pa na pyet neve, se.

PIRROJA — Përse e ke fjalën, o xha Kaso?

KASOJA — E di ti, mor bir, atë meselenë e çifutit?

PIRROJA — Jo, s'e di.

KASOJA — E po domosdo që s'e dini ju të rinjtë, se po ta dinit nuک do të flisnit kështu, de. Çifuti, kur vete për blerë mall, e pyet atë që e shet: «Vetë e ke vënë, apo ta ka lënë yt atë?» Në e pastë vënë vetë, çifuti i jep hakun deri në groshin e fundit, po ia pat lënë-i ati, bën si bën dhe ia merr me gjysmën e hakut. Ja, kështu është edhe puna juaj.

PIRROJA — S'fole hiç mirë, o xha Kaso, e s'të patën hije ty këto fjalë.

KASOJA — Ja?! S'fola mirë, ë? E pse?

PIRROJA — Sepse ne s'po kërkojmë as të shësim e as të blejmë mall, po të bashkojmë mall e

gjë e krahë dhe zotrote e di se ku ka bashkim, ka edhe fuqi.

KASOJA — Ecë, mor aty, se nuk ju dhimbset toka ju të rinjve, po pa na pyet neve, që s'rrojmë dot një sahat pa vlagën e saj. E di atë rrapijn e vjetër te luadhet? I ka rrënjet të ngulura thellë ai. Provo, provo ta shkulësh. E, ja, kështu, me sa shkulet ai, aq ndahemi edhe ne nga toka.

PIRROJA — Jo, more? Po pse ne hunj të shkulur jemi?! Kjo tokë e paktë që kemi edhe neve na dhimbset me xhanë, sepse që pesë vjeç ia kemi bërë yzmetin e jemi robtuar bashkë me ju pas saj. Pa shikoja, shikoja duart Nurkës tënd, se si ia ka trashur toka. Por, ama, edhe kjo e shkretë dhemshuri me karar dhe kur duhet. Malli dhe gjëja prapë tonat kanë përtë qenë, bille ca më tepër dhe më përmbarë ka përtë na dalë. Pse, ore, kështu do të mbetet fshati gjithë jetën, a? Duam të shkojmë më tej ne, o xha Kaso, më tej dhe të gjithë bashkë.

KASOJA — (*Ngushtë*.) E, e. Po qe për llaf, s'jua del dot njeri juve të rinjve, jo. Atë punë na i lini neve, se jemi një çikë më të regjur se sa ju. Ju bëni ç'tju themi ne. Ja, kështu (*Pauzë*.) E po ika unë, se jam ca i lodhur e dua të shtrihem. (*Ikën*.)

PIRROJA — Kokë më vete je edhe ti, o t'u mbylltë! I do gjérat të bëjnë mu, pa të bindesh. (*Hyn Nurka*.) Ia dhe, mo?

NURKA — Në dorë Besnikut. Dikush të kërkon në oborr. Po të pret. (*Pirroja del.*)

SHEGA — Po ku je, more? Nga na humbe kështu
ditë të tëra?

PIRROJA — Po ti?! Kush të tha që jam këtu?

SHEGA — Ti më thirre.

PIRROJA — Unë të thirra?!

SHEGA — E mo, Nurka më tha.

PIRROJA — Nurka?!

SHEGA — Jo po, po të duash iki unë.

PIRROJA — Na, moj, ku do të vesh tani.

SHEGA — E di ti që edhe babai u bë merak për ty.

PIRROJA — Ja?! Si dihëndër kështu, apo si Pirro?

SHEGA — Atë nuk e di unë se si. Po ta mbajti, shko
e pyete vetë. Po ç'u bëre, ç'u bëre?

PIRROJA — Ashtu i kam patur punët. (*I afrohet.*)

Kam rënë në ca gjurmë të bandës, po hap sytë
se ia thua njeriu.

SHEGA — Prapë kishin hedhur letra ata në nja 2-3
shtëpi, o Pirro. Po mirë. E si pastaj?

PIRROJA — I çova fjalë shokut Demir të afrohet me
forcat e ndjekjes dhe pastaj vajta mora Hys-
kën dhe kemi tre netë që po e gdhijmë majë
një plepi duke përgjuar.

SHEGA — Prandaj të qenkan nxirë sytë, ë!

PIRROJA — E moj, se sytë prapë çelen, po të shtiem
në dorë bandën një herë.

SHEGA — Po mua pse më thirre?

PIRROJA — Pse të thirra? Po që të të shoh, moj, se
më mori malli, ja pse?

SHEGA — E ke zgjidhur si shumë gjuhën ti, djalo,
po një çikë më urtë. Pse s'vije dot ti nga shtë-
pia për të më parë?

PIRROJA — S'kam ikohë, Shegë, për kokën tënde.
Erdhëm me Hyskën sa për të marrë ndonjë gjë
për të ngrënë dhe do të nisemi që tani.

SHEGA — Po pse, prapë do të ikësh? (*Me turp.*) Sa i lig që je.

PIRROJA — Duhet, moj Shegë, duhet të iki, se më duket sikur këtë herë i kam rënë më të.

SHEGA — (*E emocionuar dhe me turp.*) Dhe ki kujdes! Hap sytë, se pastaj s'të flas, ë. Jo ashtu, siç e ke zakon, turru, o burra, se edhe ata kanë armë, edhe plumbi i tyre shpon. Dëgjove? S'të flas me gojë, po të gjeti gjë.

PIRROJA — Për kokën tënde, Shegë, këtë herë do të jem më i urtë dhe më i përbajtur, se, ja, po afron dita t'ia bëj «bramp» Rrapos.

SHEGA — Ja të shohim.

PIRROJA — Aha, tani i erdhi fundi. (*Nga jashtë ndihet zëri i Hyskës që thërrret «O Pirro! O Pirro!»*) Erdha, erdha, o Hyskë. (*Shegës.*) Ika, Shegë.

SHEGA — Kaq shpejt? Rri dhe ca, më qafsh!

PIRROJA — Po pret Hyska jashtë e s'kam si t'ia bëj.

SHEGA — Ou dhe ti, sa i lig që je!

PIRROJA — Prandaj më do, se jam i lig?

SHEGA — Prandaj, po pse?

PIRROJA — E po mirë, meqë jam i lig, po iki.

SHEGA — Po kaq shpejt?

PIRROJA — Nuk më përqafon?

SHEGA — Po kërkon si shumë. Prit, prit, se akoma s'jam bërë gruaja jote.

PIRROJA — Moj, po sot do të më përqafosh se s'bën, ndryshe pastaj do të të përqafoj unë.

SHEGA — Pa bëje provë një herë, pa të shohësh.

PIRROJA — E ç'do më bësh? (*Hap krahët, Shega i afrohet dhe e përqafon përmallshëm.*)

SHEGA — Ja ç'do të të bëj. (*I bie me shpullë.*)

PIRROJA — Bobo, ç'dorë! E po doemos e bija e Rra-

pos. Mirupafshim, Shegë! (*Nurkës.*) Ti, Nurkë, s'pe gjë, ë?

NURKA — As pashë, as dëgjova gjë.

SHEGA — Mirupafshim dhe hap sytë. (*Ndahan.*) Po të pres, ë!

PIRROJA — Do të vi se s'bën. (*Duke ikur, Nurkës:*) E solle? Tani përcille.

NURKA — Mos ki merak! (*Në kohën që del Pirroja, janë afruar te porta Teli me Dautin.*)

HYSKA — (*Nga jashtë.*) Nga kështu, o Daut?

DAUTI — E po ja, dola njëherë, o Hyskë.

HYSKA — Për të kafshuar gjëkundi kështu, a?

DAUTI — E pse na bini më qafë ne të zinjve? Ne jemi bërë sus.

HYSKA — Sus kur s'të shkon, pa kur të shkon i ngul dhëmbët gjer në kockë ti. Hap sytë, se do ta pësosh. (*Largohet me Pirron. Teli me Dautin futen në oborr.*)

TELI — (*Që në oborr.*) O Kaso! O Kaso! A je aty, more?

KASOJA — (*Që brenda.*) Këtu, mor, këtu jam. Eja ni brenda. (*Teli me Dautin futen në dhomë, ndërsa Nurka me Shegën dalin.*)

TELI — Demek të themi, vetëm qënke, ë?

KASOJA — Vetëm, or, vetëm, po urdhëroni, uluni. (*Ulen.*)

DAUTI — Po si më je, more Kaso, me grua e me fëmijë?

KASOJA — Mirë, shyqyr, mirë. Po të na lenë rehat, mirë jemi, o Daut, s'ka më mirë.

DAUTI — Ashtu është vërtet. Hak fjalë. Mirë, mi-ri-je-jemi-tani. Shyqyr veç të mos na trazojnë. Ja, edhe ligjin e ri të grumbullimeve, me zor, por po e honepsim, veç më tej mos shkofshim.

KASOJA — Ligjin e ri the?!

DAUTI — E po s'është i paktë, de. A po hajde de, se mban fshatari. U pa kjo punë. U dashka që të prodhojë kjo tokë edhe mish, edhe lesh dhe vezë... edhe...

KASOJA — S'është ashtu, o Daut, jo. Ka halle shteti.

TELI — Ka halle shteti, Daut.

DAUTI — (*Dredhon.*) Ka, ka. E po prandaj e thashë edhe unë që, me zor, por po e honepsim.

KASOJA — Hë! Ashtu de!

TELI — Demek të themi, takova Dautin rrugës, o Kaso, e, demek të themi, mezi që e kandisa të kthehem tek ty.

DAUTI — E po jo për gjë tjetër, po gjersa e duam njëri-tjetrin lipset edhe ta mbrojmë nga belaja, Kaso.

KASOJA — E po ne s'do të ndahemi për së gjalli me njerëzit, o Daut. Në je kulak, je për veten tënde, por, ama, je edhe njeri, jemi fshatarë e rritur bashkë.

TELI — Demek të themi, mirë e the, o Kaso! Hak fjalë!

DAUTI — Mirë vërtet e tha, po ç'thotë Rrapoja se? Rrapoja shkuarjen e miqësisë e vëllazérinë t'i quan politikë e të ngatërron keq, mor vellezër.

KASOJA — E po, ç'ne politikë muhabeti që bëjmë ne, o Daut? Ç'hyn politika në hallet tonë e në punët e kooperativës? Politika merret me inglizin, me rusin, me Amerikën. Pastaj s'mbetti politika ta vërtitë Kasoja, Teli dhe Daut Zullumi, de.

DAUTI — Tamam. fjalë me vend, po kujt ia thua, se. Rrapoja çdo gjë kërkon ta zgjidhë me hu. O

thuaj kështu si them unë, thotë, o të vrava. Mirë me ne, se ia do puna, meqë na e kanë vënë këtë damkë e s'kemi nga lëvizim, por, amë, jo edhe me ju, mor vëllezër, jo edhe me ju!

TELI — Demek të themi, është një çikë i sertë ai, po ia do puna, o Daut, ia do puna.

DAUTI — Po çdo gjë me karar, mor Teli vëllai, se është dynja kjo e shkretë e s'dihet si i venë punët më tej, e tjetri ka të drejtë të mendohet para se ta hedhë hapin. Hyrë në kooperativë, thotë Rrapoja, ndryshe je armik. Po mirë, mor vëlla, gjersa ti thua që kooperativa është për të mirën e fshatarit, cili është ai qerata që i bie së mirës me këmbë, ë? Asnjë! Aherë lëre tjetrin të bluajë me mendjen e tij dhe kur t'i mbushet, le të futet. Pse kjo axhele, xhanëm? Pse kjo forcë? Gazetat shkruajnë që «të mos nxitohemi në punën e kooperativës», «ka kohë, pret kjo punë», kurse ti vjen e më thua ndryshe. Je vërtet pushtet e ta do puna, po mbi ata që janë lart s'ke si del, de.

TELI — Pse, demek, të themi, vërtet thonë gazetat kështu, o Daut?

DAUTI — Po më placin këta sy, mor vëllezër, që s'ka as djalë as çupë mbi ta, që kështu e thonë. Po është shkruar, bre, e jo vetëm e thënë.

KASOJA — Kështu, kështu është, or Teli. Edhe unë s'e besoja, por Jani nxori dhe ma këndoi edhe në libër.

DAUTI — Po kështu është, o, pos! Ja, shiko gazeten. (Asnjeri s'di ta lexojë.)

TELI — Po mirë, o Kaso, demek të themi, po Nurka yt, si me gramë që është, nuk ta paska kënduar këtë që thënkan gazetat e librat?

KASOJA — Ma ka kënduar, or Teli, ma kënduar, po seç shton edhe ca fjalë të tjera e seç më nga-tërron siç ia do mideja atij, që të ma prishë mendjen mua.

TELI — Demek të themi, mirë, mirë e the. Hak fjalë! Hak fjalë! Këta të rintjtë, demek të themi, na janë bërë havale e duan, demek të themi, si e si të na e prishin mendjen neve për në kum-perativë.

KASOJA — E po i riu si veriu, more Teli. Për të ç'fluturon hahet.

DAUTI — Pastaj, mor vëllezër, lëre tjetrin në hallet që ka. Secili e di vetë ku i pikon shtëpia. Po kanë halle njerëzit, mor vëllezër, kanë halle. Ja, atë më thoshte Naumçja i Kolit, Demka e Zyloja një ditë. Duan të hyjnë, po kanë halle, mor vëllezër. Njëri ka djalim ushtar e pret t'i lirohet, tjetri ka për të martuar çupën dhe i treti sapo hodhi themelet e një cope shtëpie.

TELI — Çupat, more Kaso, çupat. Më ngelën çupat, demek të themi.

KASOJA — Ashtu është vërtet, secili e ka nga një hall.

DAUTI — Mirëpo, po hynë në kooperativë, s'u japid dot rrugë hallevë, sepse s'kanë ku të kapen, vëlla. Nga malli dhe nga gjëja i lanë duart. Ti e unë, e tjetri s'kemi për vete e jo t'i ndihmojmë ata. Si të bëjë i ziu njeri?!

KASOJA — Mjerë njeriu i zi me një barrë hallesh mbi supe.

DAUTI — Po kështu është, o po si! Na, mor, na! Po ti po m'ia hoqe tokën fshatarit, ma vrave, mor vëlla, ma vrave, se ajo tokë e ka mbajtur gjallë tërë jetën. Lere pastaj dhemshurinë për

mall e gjë, që më mirë të të marrin shpirtin,
se sa ato.

TELI — Demek të themi, mirë e the, o Daut. Na dhimbset për kiamet demek të themi, ajo pak kamje që kemi.

DAUTI — Kështu është, o pos! Pastaj, or vellezër, edhe shumë e qëruar s'më duket kjo punë. Fjala mos na daltë, po kështu është: ta dha tokën me dorën e majtë dhe po ta marr me të djath-tën.

KASOJA— Ej! Jo, jo, gjer këtu nuk venë punët, o Daut. Këtë e di si bukën që ha. Lëre ç'flasin gojët e liga.

DAUTI — E po allahu na ruajtë, o Kaso. (*Dredhon.*) Mirë thua, ka edhe gojë të liga. Mor po ne, të takëmit tonë, ç't'i bëjmë këtij kulakllékut, që na u ngjit e që është me zarar, pa ashtu jemi më mirë. Vërtet kemi një çikë më tepër tati-me se ju, por, u pa kjo punë, do të punojmë një çikë më shumë e do t'i lajmë, po ama jemi me tokën e me gjënë tonë e s'na nget njeri, jo.

TELI — Demek të themi, edhe ajo e mira juaj, e mirë e zezë është. Ç'e do kamjen, demek të themi, kur ke larg qoftë atë damkë?

DAUTI — Ashtu është, or Teli, po ç't'i bëjmë, se mos e kërkuam. Na e ngjitën, por, ama, nga kamja, e kisha fjalën, nga kamja jemi më mirë se ju. Po, po!

KASOJA — Epo të rroftë kamja ty, o Daut, po unë kulak nuik dua të bëhem, or jo. Lipsur qoftë tokë e gjë para nderit. Le që s'venë punët deri aty, jo.

DAUTI — (*Dredhon.*) Ashtu qoftë, vellezër. Edhe

unë ashtu them. Ashtu,është vërtet! Nejse, unë fola një çikë si tepër, por ama, i fola me zemër të hapur, se juam kam dashur dhe juam dua të mirën, pa gjetkë, jo jo, s'e hap gojën fare. Ore, ta marrin për ters mileti e venë e të bëjnë gjëmën pastaj.

KASOJA — E po muhabet po bëjmë, o Daut, muhabet e jo politikë.

DAUTI — Muhabet, or muhabet, q'ne politikë, po ta marrin për ndryshe, se. Dua ta kyç këtë të shkretë gojë, po si ta kyç, mor vëllezër, kur më dhemb këtu. Për perëndi në ia mbaj përmëllë Rrapos atë që më punoi te Luadhet e Mujos, por më vjen inat, mor vëllezër, kur ju hakërrrohet juve. Po ti, more Rrapo, kur do të ngresh kooperativë, pse s'më fut Maliqin të parin, që e ke edhe me mall e me gjë më shumë, edhe të lidhur me pushtetin? Pse budallaështë Maliqi, apoështë armik? Pse s'më fut Rustemin, qëështë më i miri i bujqëve të të gjithë fshatrave të Rrezës, po vjen e më ngul këmbë te Kasoja, te Teli e te ndonjë tjetër që, kujt mezi i tepëron diç, kush mezi mban frymën me bukë? E po, kështuështë, or vëllezër.

TELI — Demek të themi, mirë e tha, o Kaso.

KASOJA — Hë...

DAUTI — E ja kështu bëhet i keq Dauti, or vëllezër.

(*Një zë nga jashtë thërret.*) O Kaso, o Kaso!

KASOJA — Eja brenda, eja brenda, o Rustem!

RUSTEMI — (*Duke hyrë.*) Mirë se rrini!

KASOJA — Mirë se erdhe e të lumçin këmbët, o Rustem!

RUSTEMI — Ti m'i di huget, o Kaso. Jemi bujq dhe gjërat që kemi na duhen, se me to mbahemi.

Ashtru, de! Të dhashë litarët për një ditë e u
bë java që s'po m'i kthen. Jo kështu, de!

KASOJA — E shkela vërtet, o Rustom, po ashtu më
erdhën punët. E po ulu, de, ulu!

RUSTEMI — S'kam nge unë, ore. Do punë toka, kur-
se ju jemi të ngeshëm.

KASOJA — E po edhe dy fjalë do t'i këmbejë nje-
riu, de.

TELI — Demek të themi, mos na e prish, o Rustom.
Ulu, de!

KASOJA — Sa të vijë Nurka, se ai i ka ngritur. Ja,
sikur ka ardhur. (*Rustemi ulet.*)

DAUTI — E po të lumiqin këmbët, o Rustom. Të ndo-
llëm me zemër, se ty të kishim në gojë.

TELI — E, or, e. Demek të themi, ty për besë!

RUSTEMI — (*Me gëllim.*) E po prandaj më ngau ëm-
za rrugës mua, por gjer të ty, o Daut, s'më vaj-
ti mendja jo.

DAUTI — E po domosdo, mor Rustom, e kemi hijen
një çikë si të rëndë ne, ikulak hesapi, dhe nje-
rëzit ruhen prej nesh si djalli nga temjami.

RUSTEMI — Unë shoh punën time, o Daut.

DAUTI — Dhe mirë bën, po q'e do që edhe ty s'të
lenë rehat. Ta ngjitën që ta ngjitën nefkën e
«Tersit të Pishës».

KASOJA — Ashtu vërtet dhe kot së koti ia ngjitën.

TELI — Kot së koti. Kot së koti.

DAUTI — E pse? Pse the atë që duhej thënë. Po në
ka njeri që e njeh këtë tokë, q'bën e c'nuk bën
ajo, po ti je, o Rustom, se je më i miri i gjithë
buqëve të Rrezës.

RUSTEMI — S'është ashtu, o Daut, jo, dhe mua s'pa-
ra më pëlqen të më ngatërrohet tjetri në pu-
nët e mia.

KASOJA — Dale, o Rustem, de! E po jo çdo fjalë që thotë ky t'ia marrim për ters, e pse medemek, sepse është kulak. Sa për nofkën tënde, këtë e di gjithë fshati, se ta ngjiti Rrapoja me Fatkën si me zamkë.

TELI — Si me zamkë, demek të themi.

RUSTEMI — Dhe mirë ma bënë, se lëshova gjuhën para mendjes.

DAUTI — Po s'ishte për aq sa e bënë ata, po nejse.

KASOJA — E ç'the ti? S'e bën toka këtë bimë që të vë plani.

TELI — E s'e bën, e s'e bën, e s'e bën, o Kaso!

RUSTEMI — Po ç'e do që i bëri dhe i bëri fort mirë, se.

TELI — Jo, ca gjëra edhe i bën, Kaso.

RUSTEMI — Jo ca gjëra, o Teli, po të gjitha.

TELI — Të gjitha i bëri, o Kaso.

RUSTEMI — Kur më vunë në plan lullediellin, unë thuaj «s'bëhet», ata thuaj «bëhet» dhe u bë e ç'të bërë, se. Më shumë të ardhura mora. Po kështu edhe me duhanin, po kështu edhe me panxharin. Doli fjala e tyre e jo e imja. Ç'fitova unë duke thënë «s'bëhet»?. Hic, veçse humba nderin.

KASOJA — Ashtu është, vëlla, ashtu. Bëhesh edhe me turp.

RUSTEMI — Mirëpo ajo më bëri të vrash mendje, o Kaso, e të mos eci më kuturu.

TELI — Demek të themi, e si medemek, o Rusto?

RUSTEMI — Dëgjoni këtu, vëllezër. Po e thanë këta shokët e Partisë e të pushtetit për një gjë që bëhet, dijeni prej meje që bëhet ajo gjë së s'bën e jo vetëm që bëhet, por është edhe për të mirën tonë.

KASOJA — Ej!

RUSTEMI — Hiç mos u habit. Kështu është e s'e lot as topi.

KASOJA — E po jo çdo gjë, de, jo çdo gjë.

RUSTEMI — Çdo gjë, or çdo gjë. Dëgjomë mua ti, çdo gjë.

KASOJA — Edhe kooperativa, kështu?

RUSTEMI — Edhe kooperativa, pos.

TELI — Demek të themi, po aherë pse s'hyn tì?

RUSTEMI — E kush të tha ty që s'do të hyj?

KASOJA — Po këtë e di gjithë fshati, o Rustem. Bi-le një takëm pas teje mbrohen.

RUSTEMI — Këtë e di vetëm unë e s'ka si ta dijë gjithë fshati, o Kaso, dhe ai takëm që mbrohen pas meje, e kanë gabim.

DAUTI — Mirë thotë. Dëgjojeni Rustemin nesër, por jo sot, ama.

RUSTEMI — Përse e ke fjalën ti, Daut?

TELI — Demek të themi, Dauti do të thotë që muri s'lot, burri lot.

RUSTEMI — Ty s'ta vë re, o Teli.

TELI — E pse s'ma vë re mua, o Rusto?

RUSTEMI — Sepse ty aq ta pret.

TELI — Të kam rixha!...

RUSTEMI — Po fjala jote, o Daut, është me zarar.

DAUTI — Po s'thashë gjë, mor Rustem. Atë që the ti, thashë edhe unë.

RUSTEMI — Dëgjo këtu, o Daut Zullumi. Fjalët e tua edhe të holla t'i presësh, edhe të trasha, erë myk e ligësi të mbajnë por te Rustemi nuk të shkojnë ato, jo.

DAUTI — E, or vëllezër, ç'i thashë? Ja, e shikoni? Ters që ters ma marrin fjalën.

RUSTEMI — Sepse e ke me helm, prandaj. (Hyn

*Nurka, takon Telin, Rustemin, kurse Dautit
nuk i hedh sytë.)*

KASOJA — Po ty, mor birbo, tē plasën kështu? Ka edhe tē tjerë këtu.

NURKA — (*I vendosur.*) Ata tē tjerët s'kanë vend nē këtë shtëpi.

KASOJA — Gjersa jam gjallë-vetë, di unë kë fut e kë s'fut nē shtëpi. Hajt, jepi dorën Dautit!

NURKA — Kurrë! Ta di që tē vdes e s'e bëj këtë.

KASOJA — (*I nxehur.*) Kujt, mor, ia kthen kështu, ë?! Jepi dorën po tē them e mos e zgjat!

NURKA — Të thashë një herë që kurrë dhe pikë!
Oj!

KASOJA — (*Rrëmben mashën tē qëllojë Nurkën.*)
E po na aherë! (*Rustemi e frenon.*)

RUSTEMI — Je më vete, more?! I ke mendtë, apo tē dolën? Të vrasësh djalin për këtë mostër.

DAUTI — Lëre djalin, Kaso! Ka tē drejtë ai. Ia do puna atij, pastaj janë tē rinj këta, kurse ne kemi xanxën prapa. (*Ngrihet tē ikë.*)

NURKA — Ti s'ke vetëm xanxën, o Daut Zullumi, po ke dhe gjuhën nepërkë e me tē po helmon njerëzit e po ndez sherr në çdo vatër.

KASOJA — Mbylle, po tē them! (*Përpëlitet t'i shpëtojë Rustemit.*)

RUSTEMI — (*Dautit.*) Thyej, mor, qafën ti, mostër e ligë! Ç'pret? Të vritten at e bir pret?!

DAUTI — (*Duke u larguar.*) Ty, Kaso, tē kam ri-xha, nē më do, Nurkën mos ma nga, ndërsa ty, o Rustem, s'ta pata borxh. Kur tē tē vi nē shtëpinë tënde, atëherë përzemë e jo këtu. Dëgjove? Dëgjova, thuaj.

RUSTEMI — As te gardhi im s'të lë tē qasësh e jo tē tē fut brenda! Tyt aty!

DAUTI — Tyt e një çikë më tej ti e jo unë!

TELI — Demek të themi, një çikë më shtruar, xhanëm, një çikë më shtruar!

RUSTEMI — (*Dautit që është duke ikur.*) Kolerë e ndyrë! Këput qafën, se do ta pësosh, siç e pësove nga Musai.

DAUTI — (*Te porta jashtë, duke ikur.*) Eja mo, eja. Eja provoje njëherë. (*Largo het.*)

RUSTEMI — E po pritmë aty, o qen e bir qeni, e më të djallofsha që në prag e ç'ke brenda! Pritmë, o farë e keqe!

NURKA — (*E përmban.*) Pse me atë maskara do merrish zotrote, xha Rustem.

RUSTEMI — Oj po më plasi, ore! Ka mbushur fshatin për mua: «Ja, Rustemi, bujku më i mirë, s'do të hyjë në kooperativë!» Po nga e di ti, mor bir bushtre, se s'dua të hyj unë; ë?! Le po më hedh romuze edhe në sy.

TELI — Demek të themi, u bë e madhe kështu, ë?!

KASOJA — Për sebep të harramit tim.

RUSTEMI — Fajet i ke vetë, Kaso, e s't'i ka yt bir.

KASOJA — E po, s'u bë ai të më japë mend mua, de.

RUSTEMI — Por ama edhe mendtë e Dautit s'kanë ç'na duhen ty dhe mua, de.

NURKA — Se ato mend po i venë njollë kësaj shtëpie dhe po na bëjnë të zihemi ditë e natë.

KASOJA — Se ju ka marrë koka erë, prandaj. Nuk jetojmë dot pa tokë ne, jo!

NURKA — Tokën s'na e merr njeri. E jona do të jetë tërë jetën. Po nuk është mirë për shtëpinë tonë të veçohemi nga fshati. Unë këtë s'e honeps dot.

KASOJA — E ç'do të bësh zotrote. Toka është imja.

NURKA — Do hyj në kooperativë vetëm me krahët.

KASOJA — Pa tokë s'futin njeri ata.

NURKA — Ata që s'kanë, i futin.

KASOJA — Aherë këput qafën që tani. S'dua të të shoh më sytë.

NURKA — Po do vish edhe ti me mua, se më ke të vetëm, do vish edhe ti me fshatin, me Partinë.

KASOJA — Prapa diellit shkofsh!

RRAPOJA — (Nga jashtë.) O Kaso! A je aty, more?

KASOJA — Këtu, këtu jam. Urdhëroni brenda!

TELI — Demek të themi, edhe këta duheshin tani.
(Futet Rrapoja me Besnikun dhe i gjejnë të heshtur.)

RRAPOJA — Mirë se rrini!

KASOJA — (Flet nën zë.) Mirë se erdhët.

RRAPOJA — Mor, po ç'ka bërë vaki këtu, që më jini thartuar kështu, ë?

KASOJA — E po halle insani, o Rrapo. Uluni, uluni. (Pauzë, pastaj Besnikut.) Pas asaj zënkes që na ndodhi, nuk ma merrte mendja të më shkelje më në derë, jo.

BESNIKU — Jemi tanët ne, o xha Kaso. Edhe do të zihemi ndonjëherë. Veçse zënkat tonë rrahin për të mirë e s'na ndajnë dot. A po s'është kështu (Telit.) Si je, more xha Teli, mirë?

TELI — Demek të themi mirë, mirë shyqyr.

RRAPOJA — Mirë, mirë, po këtë zemëratën me kë e kini s'na e thatë?

KASOJA — E keni gjetkë zemëratën, o Rrapo.

NURKA — Ashtu na ndodhi një sherr, o xha Rrapo. Ishte këtu...

KASOJA — Mbylle, aty e mos m'i ngri më tepër!

RUSTEMI — E pse ta mbyllë, o Kaso?! Ti desh e vra ve për atë sebep.

TELI — Demek tē themi, i vemë kapak këtij muhabeti.

RRAPOJA — Rri, mor, ti aty! Ti kujton se çdo gjë e mbyll ai kapaku yt, o lumëmadh! Jo, or jo! Ka ardhur koha që tē gjithave t'u hiqet kapaku. (Rustemit.) Fol, o Rustem, si janë punët.

RUSTEMI — E si tē jenë, o Rrapo. U zu Kasojë me tē birin pér hiç mos gjë. Oj! O jepi dorën Daut Zullumit, o tē mora shpirtin!

RRAPOJA — Kujt, mor kujt?! Daut Zullumit, the? Po pse këtu paska qenë ai maskara?

RUSTEMI — Tani porsa e theu qafën.

TELI — Demek tē themi, s'tha gjë, o Rrapo, s'tha gjë!

RRAPOJA — S'tha gjë, thua?! A do tē t'i them unë një pér një fjalët e tija? Ia di gjuhën asaj mortjeje, unë, ia di.

KASOJA — E po politikë s'bëmë, de! Muhabet bëmë!

RRAPOJA — S'bëtë politikë?! Po ç'djall bëtë me tē, në mos politikë, é?

TELI — Demek tē themi, jo politikë, o Rrapo, de.

RRAPOJA — A folët pér punën e kooperativës? Domosdo që folët. Ç'e zgjat më. Politikë është kjo e kaluar politikës.

KASOJA — S'është ashtu, o Rrapo, de. Po pa uluni një herë!

RRAPOJA — Dale tē iki mirë era e Dautit, pastaj tē ulem. (Besniku ulet Rrapoja jo.)

NURKA — Era do tē ikë, o xha Rrapo, po fjala, fjalë që nguli ai si shkulet, se?

KASOJA — Mbylle ti, birboja i qenit!

RRAPOJA — Kujt, mor, m'i thua birbo ti? Nurkës?

Po atë e kemi ajkën e djemve tē fshatit, mor lumëmadh. Me tē mburemi ne e jo ti. Nurka me rininë, Nurka me punët e pushtetit, Nurka

aksioneve. Ku nuk e ke Nurkën tënd, more? Prej tij vetëm e mira në të ardhë ty, po e keqja kurrë. Dëgjomë mua. Ka të drejtë djali, Kaso! Do shkulur fjala e Dautit me rrënje nga kjo shtëpi, ndryshe ta mori lumi, ta mori.

TELI — Demek të themi, s'tha gjë me zarar, o Rrapo. Për perëndi, po. Ai tha vetëm që pret puna e kooperativës, ka kohë, ç'eshtë kjo exhele. E, demek të themi, këtë e thotë edhe gazeta, edhe libri.

BESNIKU — S'ka as gazetë, as libër që ta thotë këtë, vëllezër, jo. Këto i thonë vetëm gojët e liga.

TELI — Demek të themi, e ke kabim, o Beso. Jania ka kënduar Kasos edhe në gazetë, edhe në libër.

RRAPOJA — Kush, mor kush, Jani the?

TELI — Jani i grumbullimit.

BESNIKU — E si thoshte ajo që të këndoi Jani, o xha Kaso?

KASOJA — Hollë e gjatë mos më pyet, o Beso, se s'di të ta shkoqis, por këtë e mbaj mend: ««Të mos nxitohemi në punën e kooperativës».

BESNIKU — Vetëm «të mos nxitohemi»?

KASOJA — Kështu tha ai që ishte shkruar, më tej s'di unë.

RRAPOJA — (*Këmben vështrimin me Besnikun, pastaj Nurkën.*) Të ma gjesh Janin dhe të ma sjellësh këtu. Të kërkon Rrapoja, thuaji. (*Nurka del.*)

RUSTEMI — Po dal edhe unë vëllezër.

RRAPOJA — Prit, o Rustem, prit dhe na fal që të lamë mënjanë, po e kemi pisk me këta të dy. Na lipset edhe ndihma jote.

RUSTEMI — Ndihma ime, the?!

RRAPOJA — E, ore, pse habitesh ti? Kur thashë që na lipsesh, nuk desha të të krihja bishtin, por ta thashë se ashtu është. Do vinim edhe tek ti, po gjersa të gjetëm këtu, ia themi ato fjalë që kemi për t'ia thënë njëri-tjetrit. Ulu, ulu rri! E, ku e kishim fjalën? (Nxehet.) Ma prishe gjakun, o Kaso, që u prishç nga mendtë.

KASOJA — E ç'faj të kam unë, o Rrapo!

RRAPOJA — Po si, bre, ç'faj më ke ti? Po më dhimbesh, mor vëlla, se je yni, bre, e s'të shoh dot të m'u bëhesh ferrë hallevë të popullit e të Partisë.

KASOJA — O Rrapo, të kam rixha, mua mos më ngatërrro me Partinë ti! Dëgjove?! E dua jo më pak se ti e s'ka gjë që të më ndajë prej saj. Ashtu, de! Por, ama, atë që kërkon ti, unë s'e bëj, or jo. S'hyj në kooperativë dhe pikë.

BESNIKU — Si kështu, o xha Kaso? S'hyn në kooperativë për inat të xha Rrapos?

KASOJA — E po kooperativë me zor s'ngrihet, de, dhe as njerëzit nuk i detyron dot për të hyrë.

BESNIKU — Ashtu është, xha Kaso. Kooperativë me zor s'grihet dhe as njerëzit me zor në të nuk futen, po a nuk më thua, o xha Kaso, kush po e ngrë me zor kooperativën dhe kush po të detyron ty të hysh? Asnjeri. Atëherë? Ja që s'folle mirë. Këto fjalë leri t'i thonë kulakët e jo zotrote. Po pak përpëra këtu paska qenë Dauti dhe Rrapoja e tha mirë se cila është gjuha e tij.

KASOJA — E po e thashë një herë, të shkretën, që muhabet bëmë e jo politikë.

BESNIKU — Nuk është ashtu, o xha Kaso, jo. Dëgjo Beson. Ti vërtet mund të jesh nisur për mu-

habet me Dautin, por ai ka bërë politikë të holë dhe të ndyrë me ty e me Telin bashkë dhe a e di pse, sepse e keni lënë ju ta bëjë këtë.

KASOJA — Ej?!

BESNIKU — E po ja, prandaj ne s'mund të rrimë e të bëjmë sehir se si do të venë punët, se jemi komunistë, o xha Kaso, dhe e kemi për detyrë t'u qëndrojmë njerëzve pranë, t'u flasim e t'u tregojmë të vërtetë. Ne duhet t'ia hapim barkun njëri-tjetrit, o xha Kaso, sepse ka edhe gjëra që s'i dimë, pa ka edhe gjëra që s'i kuptojmë apo që edhe ndokush na i thotë ndryshe për ndryshe dhe të gjitha këto duhet t'i bëjmë me dorë në zemër, xha Kaso, me dorë në zemër.

KASOJA — Po mirë, more bir, le t'ia themi ato që kemi për t'ia thënë njëri-tjetrit dhe, ashtu siq the ti, me dorë në zemër, por, ama, edhe ta lemë tjetrin të mendohet e të mos e detyrojmë.

BESNIKU — Domosdo që do të mendohemi dhe pasi të jesh menduar, xha Kaso, po t'u mbush futu, s't'u mbush, mos u fut. Njeri s'të detyron.

KASOJA — E po kështu folmë mua, de.

RRAPOJA — Kështu ju kemi folur ngaherë ne, o Kaso, ty e Telit me shokë, paçka se ne s'dimë t'i shkoqisim gjërat kështu si Besoja.

KASOJA — E po fjala po s'qe e lidhur dhe e goditur, nuk shpon dot në zemër, o Rrapo, jo.

RRAPOJA — Aty jam me ty. Ashtu është vërtetë. Fjala është si plumbi, që po s'pati forcë nuk shpon.

BESNIKU — E po ja, o xha Kaso, do thuash ti pse rrähim ne të ngremë kooperativën? Po sepse

atë po e kërkojnë vetë fshatarët, bre. Dhe a e di zotrote pse e kërkojnë? Sepse duan të jetojnë jo ashtu siç kanë jetuar, në skamje e në varféri, por ndryshe, ashtu si duhet jetuar. Ka zëra që thonë se «fshatarit s'i duhet gjë tjetër vec kripa, vajguri dhe dy kut pëlburë». Ka zëra të tjerë që thonë «O po të na lënë rehat, se mirë jemi edhe kështu». Si thua ti, xha Teli, ka apo s'ka zëra të tillë?

TELI — Demek të themi, edhe ka, more bir.

BESNIKU — Ashtu, de. E po këto zëra, vëllezër, ta themi troç, i nxjerrin ata që s'na duan as ne, as pushtetin tonë, mirëpo një takëm, pa i menduar, i gëlltitin. Si thua ti, xha Kaso?

KASOJA — E po edhe ashtu mund të jetë, o Beso.

BESNIKU — Kështu, kështu është, xha Kaso, Dëgjo Beson ti. Tani, ja të të pyes ty, o xha Kaso, edhe ty, o xha Teli, mos duhet t'u themi ne Dautëve: ashtu është siç thoni ju, kini të drejtë? Hë, o Kaso? Fol, o Teli! E, jo! Këtë as e themi as kemi për ta thënë kurrë, sepse me kolektivizimin Partia rreh për më tej, rreh për më mirë. Ajo kërkon dhe lufton që fshatari t'i ketë të gjitha dhe me bollëk, që ai të jetojë si njeri e jo si qen. Po pse, mor vëllezër, nëpër kasolle do ta ngrysim jetën ne dhe bijtë tanë? Kështu do të vishemi ne tërë jetën me zhele? Me bishtukë e me kandilë do t'i ndriçojmë tërë jetën kasollet tonë? Apo mos duhet që tërë jetën fshatari ynë të mbetet në padije dhe në errësirë? Ja që s'u dashkan vetëm kripa dhe vajguri për fshatarin, por shumë e shumë gjëra të tjera. Pastaj, ç'thoni ju, mos vallë tërë jetën duhet të zihemi e të vritemi me njëri-

-tjetrin pér një copë gardh, pér një gur mezhdniku dhe pér një vijë ujë? Hë, more Kaso, fol, se pér to iku yt vëlla.

KASOJA — Mos m'i hap ato plagë, o Beso.

BESNIKU — Po na dhëmbin, o xha Kaso, na dhëmbin, prandaj i hapim. E, ja këtë kërkojnë armiqtë tanë.

RRAPOJA — Dëgjoni, dëgjoni! Hë më të lumtë ajo gojë!

BESNIKU — Po pse, bre vëllezër, a nuk do t'jua kishte ëndë që në shtëpi të ndriçonte drita elektriqe dhe të buçiste kënga dhe muzika e radios? Mos ju duket ëndërr kjo? Jo, or jo! Nuk është nga ato Partia jonë që sheh ëndrra me sy hapur. Ajo mendon ditë e natë, punon, lufton, që të gjitha këto t'i ketë e t'i gézojë fshatari dhe unë po ju them që një ditë doemos do t'i ketë. Por kur do të vijë kjo ditë, do të thoni ju? A, kjo varet nga ne, nga rruga që do të zgjedhim ne pér të ecur tash e paskëtaj.

RRAPOJA — Domosdo, nga qielli nuk zbresin të mirat.

BESNIKU — Ja pse duhet parë më urtë e më thellë puna e kooperativës, pa mërrira e pa inate, o xha Kaso, se e keqja kurrë s'ka ardhur nga bashkimi po nga veçimi. E dini ju, bre, si lindi e keqja në këtë botë, si lindi kamja dhe skamja, zengjini dhe fukarai? Ja t'jua them unë. Të gjitha lindën kur lindi prona, d.m.th. kur lindi veçimi i tokës dhe i krahëve të punës e që këtej lindi tahmaja, lakmia, e liga dhe gjithë ndyrësitet e tjera. Po të bashkohet toka e krahët, shporret skamja njëherë e mirë, pastaj fillojnë e shuhen tahmaja, ikën ligësia dhe

në vend të tyre vjen bollëku, forca, shkuarja e gjithë të mirat me radhë.

TELI — Demek të themi, nuk thotë keq, o Kaso.

KASOJA — Mirë thotë, o Teli, mirë, por...

BESNIKU — Prandaj mua do të ma donte zemra, o xha Kaso, që ti e Teli të ishit në krye të listës për të hyrë në kooperativë. Edhe nderi juaj këtë kërkon.

RRAPOJA — E ku i lë Dauti ata të jenë në krye të listës. Ai s'i lë të jenë në fund e jo në krye që jo e jo.

KASOJA — Të kam rixha, o Rrapo, mua me Dautin mos më ngatërrro. Ta thashë një herë!

RUSTEMI — E pse të ardhka rëndë të të ngatërrojnë me Dautin, kur ti me të m'i qan hallet mbarë e prapë? Le po kërkuar të më ngatërronit edhe mua. Hyj apo s'hyj unë në kooperativë, ajo është puna ime. Ashtu de!

KASOJA — Unë thashë ato që flet fshati për ty, o Rustemi, e s'i nxora nga xhepi ato fjalë, de.

RUSTEMI — Qëparë s'ta thashë, se të kurseva, o Kaso, po tani ja ku po ta them në sy edhe ty, edhe Telit. Ato fjalët në fshat, o Kaso, që «Rustemi, bujku më i mirë, nuk hyn në kooperativë» e kanë burimin te Dauti e që andej ti me Telin e me ndonjë tjetër i keni çuar derë më derë. E në doni të dini fjalën time për kooperativën, nuk pres ta them nesër, po e them që sot, këtu: shënomëni dhe mua!

RRAPOJA — Të lumtë, o Rusto vëllai.

(*Hyn Jani.*)

JANI — Miredita, shokë!

RRAPOJA — Unë të thirra, o Jani.

JANI — Urdhëro e fol, xha Rrapo.

RRAPOJA — Sikur na i ke ngatërruar punët me Kason, o Jani, dhe na i ke ngatërruar keq.

JANI — Punët me Kason, the?! Mos e dhëntë zoti! Kasoja është nga të parët që i ka çlyer detyrimet. Në kandar s'di t'i kem ngrënë gjë. Fol, o Kaso.

RRAPOJA — Ato i dimë ne, po e kemi gjetkë fjalën, gjetkë.

JANI — Urdhëro e fol me se tjetër.

RRAPOJA — Ja, me ato që u ke kënduar këtyre shokëve nga libri e nga gazeta, ku gjoja, u thënka që «të mos nxitohemi, pret puna e kooperativës!»

JANI — (Qesh.) Për këtë më paske thirrur, a?!

RRAPOJA — (Serioz.) E, pér këtë, pér këtë. Pse, si të duket ty kjo? Ta kishte thënë ndonjë tjetër e po hajde de, po jo ti që je me gramë.

JANI — Po atë e dinë të gjithë, mor xha Rrapo. Ajo është thënë kudo.

BESNIKU — Cila është thënë? Pa ta dëgjojmë!

JANI — Po ja, bre, ajo që thonë që: «Në çështjen e kolektivizimit as të mos nxitohemi e as të mos qëndrojmë në vend».

BESNIKU — Kjo po, kjo është thënë, por s'është thënë ajo tjetra, që u është thënë fshatarëve, se.

JANI — Unë s'u kam thënë gjë fshatarëve. Vetëm se ua kam lexuar.

RRAPOJA — Ej! Hë, more Kaso, kush gënjen tanë?

TELI — Demek të themi, është marrë jangëllësht, o Rrapo.

RRAPOJA — Ja ta shohim, është marrë apo është dhënë jangëllësht, o Teli.

BESNIKU — Se është bërë gjysmak ai lexim, o xha Teli.

JANI — Si gjysmak?

BESNIKU — Partia dhe Komandanti kur i thonë gjërat, i thonë të plota, o Jani, e jo kështu të qethura e të cunguara sipas midesë së secilit.

JANI — Unë s'jam nga ata që qethin e cungojnë orientimet e Partisë. Shikoni se mos është tjetër dorë këtu. Ore, xha Kaso, ç'ke ngatërruar kështu?! Unë ta kam kënduar ashtu siç është shkrojtur, e zeza mbi të bardhën.

BESNIKU — Që «as të mos nxitohemi, as të mos qëndrojmë në vend».

JANI — Po, tamam kështu, shoku Besnik, «as të mos nxitohemi, as të mos qëndrojmë në vend».

KASOJA — Dale, o Jani, dale, se atë të dytën ma ka kënduar Nurka e jo ti, bile unë u nxeha se ia mora sikur e shtonte nga vetja.

JANI — Jo, or vëlla, jo. Unë ta kam kënduar të plotë, por ty të është ngulur në kokë ajo «të mos nxitohemi», sepse ajo të vjen pas midesë. Të kam rixha, mos na hap sherr pa punë tani. Oj!

KASOJA — Se cila më vjen mua pas midesë, është tjetër punë, o Jani, por në kokë mua më ka mbetur vetëm ajo «të mos nxitohemi». Kaq di unë.

BESNIKU — Dhe jo vetëm ty, por edhe ca të tjerëve, o xha Kaso.

JANI — Shoku Besnik...

BESNIKU — Dale, more Jani. Puna është që një takëmi njerëzish u lexohet ose u thuhet vetëm pjesa e parë e këtij orientimi ndërsa e dyta s'u thuhet fare dhe kjo kuptohet pse bëhet. Bëhet për qëllime jo të mira.

JANI — Domosdo për qëllime jo të mira, po pse ma thua mua?

RRAPOJA — Po pse ta tha nuk të vau, o Jani. Megjithëse, po të më pyesësh mua, këtyre që flasin kështu u duhet prerë gjuha që në rrëzë.

JANI — Të lutem shumë, shoku Besnik, gjuha kocka s'ka e kocka thyen, prandaj të matemi para se t'i lëshojmë fjalët. Ashtu, de. Boll telash kam atje në grumbullim e jo të më vijë një analafabet, si Kasoja, e të më ngatërrrojë kot së koti. A!... Duhen kthjelluar mirë këto punë. Po, po, duhen kthjelluar.

BESNIKU — Por ama t'i kthjellojmë e jo t'i turbullojmë ca më keq. Duhen thënë gjérat ashtu siç janë, o Jani, se pastaj edhe nga një fjalë e vetme na turbullohet vija e Partisë. E këtë, ne s'kemi për ta lejuar kurrë.

JANI — Po pse, mos kujton ti se do ta lejoja unë. Trokite në derë të shurdhët, o shoku Besnik.

BESNIKU — Nuk e di akoma është apo s'është e shurdhët dera ku trokita, por një gjë di sagllam, që armikun e kemi në fshat.

JANI — Gjejeni! Po mua s'ka përsë të më përqasësh me armikun.

RRAPOJA — Po s'hëngre hudhra, nuk qelbesh, o Jani. Mos ki merak.

JANI — Nuk kam atë merak, veç më vjen inat që këta më ngatërruan kot në këtë mesele.

RRAPOJA — Megjithatë, o Jani, për mua nga kjo mesele, edhe në s'ta vumë atë damkë, pa gjë s'del as ti, jo.

JANI — E po këtë që thua ti se gëlltis unë, or Rrapo, sikur kiameti të bëhet. Ky është presion, është

kërcënim i hapur dhe unë do të ankohem gjer lart.

BESNIKU — Ku të duash shko veç mos harro ato që të thashë unë.

(*Jani del me rrëmbim duke thënë: «Dakord!»*)

RRAPOJA — Prapa diellit vafsh! Hë, gjidi pusht, gjidi pusht!

BESNIKU — Ç'janë këto që lëshon, o xha Rrapo?

RRAPOJA — Hiç, or hiç.

BESNIKU — E po nxirrja kokën, de. Këtu tanët jemi të gjithë.

RRAPOJA — Ky pusht është ai që hyn e del në shtëpinë e Bektash beut.

BESNIKU — Pse s'ma ke thënë më përpara?

RRAPOJA — Sepse mbrëmë erdhi e më tha Piloja, pastaj s'do të merremi ne me ndyrësirat që bën ai me të venë e Bektash beut.

BESNIKU — (*Mendon.*) S'është edhe aq e thjeshtë sa mendon ti, jo.

RRAPOJA — Si?!

BESNIKU — S'është aq e thjeshtë sa mendon ti. Apo jo, o Nurkë?

NURKA — Edhe unë ashtu mendoj...

BESNIKU — Ashtu, ashtu është. Nejse, ka për t'i dalë tymi edhe kësaj pune së shpejti (*Nga jashëtë ndihet zëri i Maliqit që thërret.*)

MALIQI — O Kaso, o Kaso!

KASOJA — O, mor, o. Eja brënda, o Maliq!

MALIQI — A është Rrapoja aty, more?

NURKA — Urdhëro brenda, xha Maliq, se këtu është. (*Hyn Maliqi me Fatimen.*)

FATIMJA — (*Turret drejt Rrapos.*) Rrapo, të keqen motra, fëmijët!

RRAPOJA — Fol, moj, ç'të ka gjetur?

FATIMJA — E shoftë mortja farën e ligë të armikut, o Rrapo, që s'më lë me hallet që kam, po kërkon të më verë dorë edhe mbi fëmijët. Fëmijët, Rrapo, se ti m'i di hallet!

RRAPOJA — E po fol, moj e uruar, si e ke hallin, de?

BESNIKU — Qetësohu, nënë Fatime, qetësohu dhe thuana ç'të ka ndodhur.

FATIMJA — Ja, vëlla, ç'më ka ndodhur (*I jep letrën Besnikut.*)

MALIQI — E po, durohet kjo, more?! Venë e më kërçenojnë një copë grua me tre fëmijë.

FATIMJA — Jetimët e nënës.

BESNIKU — (*Lexon:*) «Ti, moj bushtër e kuqe, që u ngrite e para në mbledhje për të hyrë në kooperativë, të shkosh e t'u thuash komunistëve se s'ke për të hyrë, ndryshe... ndryshe të tre fëmijët në një ditë ke për t'i nxjerrë xhenaze nga shtëpia. Në të dhimbsen vërtet, bëj siç po të porositim, ndryshe ne të dolëm borxhit!»

RRAPOJA — Me nder mexhlizit, t'u rruani bishtin!

FATIMJA — I preftë mortja, i preftë! E dinë që jam nënë dhe venë e më ngacmojnë atje ku më dhemb më shumë, që të më trembin e të më turpërojnë para fshatit. Jo, mor, jo, s'bëhet ajo. Unë vërtet me ata fëmijë e kam lidhur fatin e për ta po robtohem por edhe vuajtjet e tim shoqi dhe nderin tim nuk i shkel unë jo.

NURKA — Të lumtë, o nënë Fatime!

FATIMJA — Po ç'kujtojnë ata, që i preftë mortja, i preftë! Mos dua të hyj në kooperativë se kam hallin tim? Ja, për ata tre fëmijë dua të hy, që të jetojnë siç duhet jetuar e jo siç jetoi i ati dhe e ëma.

RRAPOJA — Hë më të lumtë, o trimëresha e Rrapos, më të lumtë! E dëgjo këtu: sado të gjatë ta ketë dorën mavia, nuk e lemë ne, moj, të zgjatet gjer te fëmijët e tu, sikur kiameti të bëhet. Apo jo, o Beso?

BESNIKU — Do ta presim që në rrëzë atë dorë, o xha Rrapo. Po, pa na thuaj, o nënë Fatime, kur e gjete letrën? Ç'orë ishte?

FATIMJA — Hë, o Maliq, ç'orë ishte?

MALIQI — Kur solle fëmijët tek unë, ishte ora 3.

FATIMJA — E ja me të gjetur letrën mbi oxhak, rrëmbeva fëmijët dhe erdha tek ti.

BESNIKU — Domethënë fëmijët tek ti janë, xha Maliq?

MALIQI — Po, tek unë.

BESNIKU — (*Shikon letrën.*) E njëjta dorë, e njëjta gjuhë, o xha Rrapo. Ja, or vëllezër, cili është kërcënim dhe ja cilët janë ata që kërcënojnë. Ç'thuai ti, xha Kaso?

KASOJA — Turp e faqen e zezë paçin!

BESNIKU — Mos ki merak, nënë Fatime (*Tund letrën.*) se këta kriminelë i kanë ditët e numëruara.

FATIMJA — Jo, bir, jo, nuk trembet Fatimja. Unë s'erdha këtu t'ju them që hoqa dorë. Kurrë! Në më patë pak të trondit, kjo më erdhi ngaqë jam nënë, por nga imja s'loz unë, jo.

RRAPOJA — E, or Teli, grua kjo e s'i bën tërt syri.

MALIQI — Mirë e the, o Rrapo.

RRAPOJA — E po në e thashë mirë, hë, o Maliq, ç'pret?

MALIQI — E ndava edhe unë, vetëm më thoni një gjë.

RRAPOJA — Urdhëro e folë.

MALIQI — Nga ju e dua përgjigjen por, ama, e dua të
të ma thoni me dorë në zemër.

BESNIKU — Ashtu siç do t'ia thoshim vetes, xha
Maliq.

MALIQI — Për mua, me atë mall e gjë që kam. më
mirë është në kooperativë, apo më keq? (*Rrapoja kruan kokën dhe i jep shenjë Besnikut të
përgjigjet.*)

BESNIKU — (*Mendon.*) Për ty, hë për hë, s'ka si të
jetë më mirë. Kush të thotë ndryshe, të
gënjen. Por është më mirë për fshatin,
xha Maliq. Ndërsa nesër, edhe për ty ka
për të qenë më mirë, doemos më mirë.

MALIQI — Të lumtë, se më theve.

TELI — Si?! Të theu??

MALIQI — Më theu, o Teli, më theu. Shumë më ka-
në ardhur dhe më kanë thënë: «Hyr, o Maliq,
hyr, se është për të mirën tënde!» Jepja dhe
merrja me vete të gjeja ku ishte e mira ime, po
s'e gjeja dot. Unë, or vëllezër, tërë jetën i jam
përulur së vërtetës. Ky ma tha troç e më theu.
Po gjersa kooperativa qenka për të mirën e
fshatit, edhe Maliqi këtë ka dashur e do, të
mirën e fshatit. E bërë qoftë. Shënomëni dhe
mua!

TELI — Demek të themi, vërtet edhe ti, o Maliq?!

MALIQI — U vendos kjo, or Teli, po ti, o lumëmadh,
ti ç'ma tjerr kaq gjatë, në vend që të jesh i pa-
ri, se për ty bëhet më mirë.

TELI — E, or Kaso?! E po s'do pëgërrur keq ajo go-
ja e Dautit? Rustemi po, Fatimja po, Maliqi po,
epo, epo... Shënomëni edhe mua! Hë, o Kaso!

KASOJA — O Nurkë, pa shih, more, se sec më kapi
veshi një rënkim aty në oborr. (*Nurka del,*

Rustemi i vete pas. Të gjithë e kanë vëmendjen në pritje. Pas pak Nurka me Rustemin sjellin Pirron të plagosur.)

FATIMJA — O biri i nënës. (*I turret.*) Bir, bir, bir!

RRAPOJA — Lëre, moj, kujen tan! (*Tepër i shqetësuar.*) Po dale, moj e uruar! Hiqu mënjanë! Shtrijeni, mor, këtu. (*E shtrijnë Pirron duke i fërkuar ballin.*) Hë, mor biri i xhaxhait?! (*Të gjithë vijnë pranë të shqetësuar.*)

PIRROJA — (*Me rrokje të shkëputura.*) Ba...nda..., u rre-thu-a,

RRAPOJA — Po ti, si? (*E fërkon.*) Biri i babait! Trim i babait. (*Përlotet.*) Po si, mor bir, si kështu?

PIRROJA — Kur...i...dha...shë si-nja-lin Demirit, një plumb më goditi nga prapa.

RRAPOJA — Po kush ishte ky bir bushtre?

PIRROJA — Ne ishim dy, unë dhe Hyska. Unë...i... sha...përpara.

BESNIKU — Ti përpara dhe Hyska Pas?!

RRAPOJA — Mos?! Ç'më the mor bir?! Hë, qen, bir geni!

BESNIKU — T'i bëjmë zë gjithë fshatit. Ti nënë Fatime dhe ti Maliq qëndroni këtu. Të tjerët pas meje

PIRROJA — (*Përbledh forcat.*) Kisha një fjalë me ty xha Rrapo. (*Të gjithë hiqen mënjanë.*) I jam betuar Shegës për një fjalë. Dua të ta them, se s'dihet se si më venë punët.

RRAPOJA — (*E merr në krahë*) Hiç mos e thuaj, biri i babait. E di Rrapoja atë fjalë, e di. E bërë goftë. Të më trashëgoheni (*Ndihen krisma të shpeshta.*)

PIRROJA — Plasi atje! Turruni të gjithë te Gëmu-sha e Kaçakut! (*Të gjithë largohen, veç Fati-mes, Maligjt e Pirros.*)

AKTI I KATËRT

(Dekori i skenës së dytë. Sanija dhe Nurija tepër të shqetësuara grinden midis tyre.)

NURIJA — Na, moj, na, mblidh mendjen.

SANIJA — Pa lermë, moj, po të them!

NURIJA — Dëgjomë mua, do të na marrësh më qafë, do të na lesh edhe pa to.

SANIJA — Mbylle se më çmende! Nuk i lë unë ato në bahçe, moj, jo.

NURIJA — Po i nxore që andej, do të lësh gjurmë. Dëgjomë mua, motër.

SANIJA — Nuk e sheh moj, ç'po bëhet? Zien tërë fshati.

NURIJA — Nuk zien për paratë e tua, jo. Kushedi ç'hall kanë.

SANIJA — Që me ato krismat që ranë mbrëmë u prish qetësia. Tani më duket sikur njerëzit turren drejt shtëpisë sonë me urat e ndezura ndër duar. Duan të na djegin të gjallë, moj e mjerë.

NURIJA — S'kanë punë me ne, jo, mblidh mendjen.

SANIJA — Po me kë kanë, moj?

NURIJA — Piloja më thotë që kanë rënë në përpjekje me një bandë.

SANIJA — E po ja, kjo më tremb edhe mua. Aq dit, moj e mjerë. Thirrmë, thirrmë Pilon se po gdhin!

NURIJA — Mos se na more më qafë. Le të rrinë aty ku janë.

SANIJA — Jo.

NURIJA — Të paktën Pilon mos e fut në këtë punë. Eja ta bëjmë bashkë.

SANIJA — Thirrmë Pilon po të them, se s'është punë për ty ajo. Do hapur thellë, poshtë themeleve.

NURIJA — Mos kujton ti se poshtë themeleve nuk t'i gjejnë ata?

SANIJA — Sidoqoftë, aty janë më të sigurta se sa atje jashtë.

NURIJA — E, e... me atë mendje shko ti.

SANIJA — Paratë do t'i ruaj dhe nuk do t'i jap, moj, sikur kiameti të bëhet. E ç'jemi ne pa ato para, moj e zezë? Një hiç! Kush na zë ne për bishti pa ato para? Asnjë. Po unë përsë u futa në këtë valle, që të kërkon kokën? Ja, vetëm për ato para që t'i kemi për derman e që nesër prapë të na thonë me gojën plot Sanije e Nurije hanëm. Që Pishën ta sundoj prapë unë e jo Rrapot me shokë. Jo, jo! Paratë kurrë s'kam për t'i lëshuar nga duart. Thirrmë Pilon dhe mos e zgjat!

NURIJA — Sano. po sikur t'i hiqnim fare nga shtëpija e t'i vendosnim ne ndonjë vend të sigurt, p.sh. t'ia jepnim Janit t'i fshihte?

SANIJA — Janit the?! Të bukur dorë që gjete. Na o ujk më ruaj kopenë. Po Jani është nga ata, moj motër, që as kokën e tij s'e do, sa do paranë. E di ti që ai në kohën e Italisë la nëpunësllëkun dhe iu fut tregtisë vetëm nga lakmia për para?

NURIJA — Po atëherë ç'dreqin ke që jep e merr me të? C'interes ke nga ai, kur s'të bëka dot as kaq?

SANIJA — Ajo është puna ime! Nuk kanë ç'të duhen ty ato punë, jo. Thirrmë, thirrmë Pilon e mos e zgjat! (*Nurija del, pas pak hyn Piloja.*)

PILOJA — Më deshe gjë, Sanije hanëm?

SANIJA — (*Pilos.*) Pa afrohu, afrohu! A nuk më thua, kë ke dashur e kë ke besuar më shumë në këtë jetë?

PILOJA — (Që nuhat diçka.) E kë tjetër vec zotit, Sanije hanëm.

SANIJA — E po hajde betomu për atë zot, se ato që do të shohësh sonte, as natës së varrit nuk do t'ia tregosh!

PILOJA — Po ti më njeh, moj zonjë, pse më ngatërron me zotin tanë në pleqëri.

SANIJA — Betohu po të them!

PILOJA — Po meqë dashke, ja ku po të betohem për atë zot e për atë natë të varrit që unë do ta bëj gjer në fund atë që duhet bërë për këtë derë.

SANIJA — E si demek?

PILOJA — Ashtu siç ma thotë zemra, hanko, dhe siç ma do nderi.

SANIJA — Dëgjo si është puna. Në bahçë diç kam fshehur, por s'po më fle mendja për t'i lënë më tej atje ku janë. Mund të na e marrin edhe bahçen.

PILOJA — Jo xhanëm, gjer aty s'venë punët.

SANIJA — Nu k i dihet, Pilo, jo. Që të jem e qetë, do t'i fus brenda.

NURIJA — Mendohu edhe një herë, motër!

PILOJA — Mirë të thotë.

SANIJA — Jam menduar jo një herë, por njëmijë

herë (*Nurijes.*) Ti rri këtu. Unë me Pilon po merremi me atë punë. (*Dalin*).

NURIJA — Prapa diellit shkofshi të dy! (*Ora e murit bie tri herë.*) Po gdhin dhe asnje s'fjeti këtë natë! Natë më të gjatë as kam parë, as mos pafsha kurrë! Po ajo ç'ka? Ajo është bërë e bardhë si meiti. Asaj s'i ka mbetur pikë gjaku në trup. Eh dynja, dynja! Ku ishte dhe ku katan-disi shtëpia e Bektash beut! (*Hyn Jani.*)

NURIJA — Po ti? Nga hyre?!

JANI — Nga dera e pasme.

NURIJA — Edhe ti s'paske fjetur sonte?

JANI — Ku është Sanija?

NURIJA — Është matanë, Po fle. Pse, ç'e do?

JANI — Thirrma shpejt!

NURIJA — Ndonjë mandatë kështu?

JANI — Thirrma shpejt, se ashtu e kam një punë.

NURIJA — Hë, ke një punë, ë?! Prandaj të paska ikur edhe ty gjaku?

JANI — Qenke më qejf sonte, po s'ta kam ngenë.

NURIJA — Ç'ke, mos t'u zbrazen prapë xhepat andej nga qyteti e kërkon të t'i mbushë Sanija?

JANI — A do ma thérresësh, apo si e ke punën. (*Mata të futet vetë. Nurija i pret rrugën.*)

NURIJA — Prit këtu, se e thërras vetë. (*Del*)

JANI — (*Tepër i shqetësuar dhe nervoz vjen vërdallë nëpër dhomë. Pas pak hyn Sanija e ndotur dhe e çrrëgullt.*)

SANIJA — Shyqyr që e gjete derën, o Jani. Më le të rë këtë natë pa asnje lajm. Po më pëlçet tëm-thi nga frika.

JANI — Kisha hallet e mia, Sano.

SANIJA — Po unë le të pëlçisja këtu, ë? E po, fol, de! C'është kjo natë e këtillë sonte?

JANI — I kemi punët pisk. Duhet ikur, sa s'është vonë (*Hyn Nurija*).

SANIJA — (*Nurijes.*) Ikë matanë ti, te Piloja. Mos e ler vetëm,

JANI — Le të rrrijë, le të rrrijë! Ka ardhur koha t'i dijë edhe ajo të gjitha.

SANIJA — Asaj s'kanë ç'i duhen, jo.

JANI — I duhen, i duhen...

NURIJA — Tani që e gatove këtë farë çorbë, zoti Jani, tani më thua «urdhëro, haje dhe ti, Nuriye hanëm».

JANI — Ti bëj si të duash. (*Sanijes.*) Duhet ikur, sa s'është vonë.

SANIJA — E ku ta thyejmë qafën tani, mor i zi? Të gjitha shtigjet janë të zëna. (*Nurijes.*) Shko atje ku të thashë, Nuriye! (*Nuriya del.*)

JANI — Unë duhet të iki doemos. Ndryshe ju. Ju jeni femra e s'ju ngjet njeri.

SANIJA — S'na ngjet njeri, the?! Mos more?! Ke hallin e lëkurës sate tani, ë?

JANI — Dëgjo, Sanije! Nëm ç'të më japësh!

SANIJA — Ç'të të jap, more?

JANI — Nga ato, de. Do të më duhen për të ikur.

SANIJA — Dale, dale! Folmë si janë punët një herë!

JANI — E si të jenë, moj e zezë. Njerëzit tanë të kënetës, «Farefisi» ynë u shpartallua. Prita «Veshin» tërë natën, sipas fjalës që kishim lënë, por ai s'u duk gjëkundi. Dëgjova se një u paska shpëtuar, por janë ngritur gjithë fshatrat e Rrezës bashkë me forcat e ndjekjes dhe po e kërkojnë.

SANIJA — Ai kokën hëngërt, por unë kam hallin e «Veshit», se ai na i di edhe zorrët e barkut. Me-

gjithatë, nuk bie në dorë të këtyre i gjallë «Veshi», jo, po mblidh mendjen!

JANI — E vjetmja shpresë që më mban. Ai ose është vrarë, ose ka çarë e ka ikur tej nga Lajthiza e që andej matanë kufirit.

SANIJA — Pa derman. S'është aq budalla, se e di q'e pret.

JANI — Po qe kështu, shpëtuam dhe për ca kohë, jo po, morëm fund. Ja pse dua të iki. Hë, Sano, mos më vono!

SANIJA — Ç'do nga unë, more?!

JANI — Nga ato që ke mënjanë, de.

SANIJA — Ato i mori Bektashi me vete. Ti e di që ai e humbi gojën.

JANI — Ruaji t'uа thuash komunistëve këto fjalë e jo mua, se s'jam nga ata që i hanë këto pallavra (*Hyn Nuriјa*.)

SANIJA — I ha, s'i ha, unë s'kam.

JANI — Do më japësh apo si?!

SANIJA — Asnjë grosh.

NURIJA — Jepi ç't'i japësh e të thyejë qafën, se nuk e shoh dot me sy.

SANIJA — Asnjë grosh, asnjë grosh! Këtu, këtu me ne ka për të ngordhur!

JANI — Sano...

SANIJA — Kollaj të më futje edhe mua në këtë valle? Urdhëro hiqe ta heqim tanë deri në fund.

NURIJA — Mirë të thotë. Meqë e nisët këtë valle, çojeni deri në fund bashkë.

JANI — Mbylle ti!

NURIJA — E po mos e lerë time motër, de! Hajde, hidheni tanë, t'u mbajmë sehir. (*Trokët dera*.)

SANIJA — Bo, bo, mbaruam! (*Shkon te dera e me zë të mekur.*) Kush është?

BANDITI — (*Nga jashtë.*) Hape shpejt!

SANIJA — Kush je zotrote?

BANDITI — Një mik i Bektash beut, Hape!

SANIJA — (*Vështron Janin e ai i thotë ta hapë.*) Ja, një minutë. (*I bën shenjë Nurijes që të largohet, pastaj hap derën. Hyn një bandit me një fëmijë që e ka mbërthyer prej nofullash.*)

JANI — Kush je ti, more?

BANDITI — Kush jam unë, the? S'po më njeh kështu, o zoti Jani??!

JANI — Kështu siç je bërë ti, as ajo që të ka pjellë s'të njeh dot.

BANDITI — Jam Rushan Agoja i Lajthizës. Më njeh tani?..

SANIJA — Rushan Agoja, the!

BANDITI — I téri. Kam kaq orë që vetëm ec.

SANIJA — Dhe këtu e gjete të fshihesh?! Kërkon të na marrësh më qafë edhe ne? Në ke besuar përendi, dil jashtë e lena rehat në hallet që kemi.

BANDITI — Të dal jashtë, the? Mos do zotrote të vete edhe të dorëzohem?

JANI — Rushan...

BANDITI — Ku të vete? Nga të mbytem? Të gjitha shtigjet janë të zëna. Të poshtër! Kam kaq vjet që jetoj si bisha kënetave dhe shpellave për ju dhe tani më thoni dil jashtë. (*U kthen automatikun.*) Unë këtej s'dal i gjallë!

JANI — (*I trembur.*) Domosdo që këtu do të rrish. Mos ia merr për të keq Sanije hanmit, se është e shqetësuar. (*Banditi ul armën.*) Po atë fëmijë q'e ke?

BANDITI — Këtë, a? Hë! Lëre dreqin! E gjeta rru-gës mbrëmë ndaj të ngrysur. Po i çonte bukë të atit në pyll. E mora të më tregonte shtëpinë tuaj.

SANIJA — Lere të thyej qafën tani. (*Fëmijës.*) Kë-put qafën! Zbatharak!

(*Fëmija ngrihet dhe matet për të dalë.*)

JANI — Mbaje, moj e çmendur! Ç'kérkon të na bësh? Mos do të vejë e të t'i sjellë të gjithë këtu. (*Banditi e kap fëmijën.*) Ky fëmijë s'duhet të dalë i gjallë nga kjo shtëpi.

BANDITI — Ashtu them edhe unë.

JANI — Tani, pa na thuaj, or Rushan, si e qysh vaj-tén punët?

BANDITI — Për kiamet vajtén. S'di as unë ç'u bë. U rrrehuam ku s'e prisnim dhe u goditëm në befasi. Ikém nga sytë këmbët. Nuk di nga e si ika, veç pas nja dy orësh, kur gjeta këtë fëmijë e mora vesh se ku isha e nga duhej të merrja. Mirëpo ky mistrec për qime desh më çoi në duart e sigurimit. Desh e thera rrugës, kopilin. Tërë natën po më sjell vërdallë duke dashur të më çojë në gojën e ujkut. (E për-plas fëmijën përtokë.)

JANI — A thua i gjithë grupei u shpartallua?

BANDITI — E në ka tepëruar ndonjë, s'ka ku e fut kokën, jo. Janë ngritur gjithë fshatrat e Rrë-zës, o Jani, Mizë lisi, vëlla.

JANI — Demek, edhe ju morët fund?

BANDITI — Dy bashkë s'i gjen. Kurrë s'na është ngritur kurth i tillë, Pastaj, dreqi e mori, nga-herë kapos sonë dikush i çonte haber për kë-si kurthesh të forcave të ndjekjes dhe ne dil-nim prej tyre pa u lagur fare, kurse këtë herë

u gjetëm shumë gafil. Asnjë lajm, ore, asnjë shenjë, or po asgjë, or asgjë!

JANI — Demeq «Veshi» s'u bë i gjallë këtë herë?
Dëgjove Sanije?

BANDITI — Cili «Vesh»?

JANI — Hiç, hiç. Një miku ynë.

SANIJA — Ai ka çarë e ka ikur. Nuk është nga ata që bie në dorë.

BANDITI — Nuk e di për kë e kini fjalën, por atë rrugë e provuam të gjithë. As miza nuk e kallon dot kufirin ashtu siç e kishin mbyllur këta. (*Troket dera.*)

JANI — Mos e hap! Pa shih nga dritarja kush është. (*Sanija shkon te dritarja dhe lëviz pak perden.*)

SANIJA — (*E tronditur dhe e habitur.*) Po ky tani?! Ky s'ka shkelur kurrë këtu.

JANI — (*I trembur.*) Kush është moj?

SANIJA — Besniku.

JANI — Besniku, the? Pa shih, moj, pa shih edhe një herë! Ç'ne Besniku këtu e në këtë orë?! (*Troket prapë dera pak më fort. Jani banditit.*) Prapa derës, në të djathtë janë një palë shkallë që të çojnë në bodrum. Merr fëmijën dhe mos më dil prej andej pa të lajmëruar ne. Ik tani. (*Ikën.*) Vetëm është?

SANIJA — Vetëm, vetëm, po te porta çoc duken edhe nja dy hije. Kushedi më bëjnë sytë mua.

JANI — Ki kujdes, ruaj gjakftohtësinë, se është dhelpër ai. Hape!

SANIJA — Po ti?

JANI — S'kam pse të fshihem, po hape.

SANIJA — Po ç'ne kjo ardhje jote këtu në këtë orë?

JANI — Kam qenë edhe gjetiu dhe njerëzit më kanë parë. Di unë ç'ti them. Hape!

SANIJA — (*Hap derën dhe shtihet e habitur.*) Uu! Uu! Urdhëroni, urdhëroni! (*Hyn Besniku me automatik në krah dhe ndeshet ballë për ballë me Janin.*)

BESNIKU — Nuk paskam gabuar, o Jani.

JANI — Përse e ke fjalën, shoku Besnik?

BESNIKU — Të kërkova dhe, si s'të gjeta, më vajti mendja që doemos duhej të ishe këtu, te kjo strofkë.

JANI — Nuk është!

BESNIKU — Është, është!

JANI — Për fëmijën kam ardhur edhe unë, po s'ka fëmijë këtu.

BESNIKU — Jani, nxirrmë fëmijën dhe mos e zgjat! Të gjitha gjurmët të sjellin këtu.

JANI — Të gjitha gjurmët, the? .. (*Sanijes me qëllim.*) Mos më ke gënjer kështu? Shiko se...

SANIJA — Këtu s'ka asnje fëmijë. Ka vetëm dy femra dhe një plak. Tjetër unë s'di.

BESNIKU — Banditi dhe fëmija i grabitur prej tij janë këtu. Të gjitha gjurmët këtu të sjellin.

JANI — E cilat janë ato gjurmë që ju sjellin këtu, morë shoku Besnik, se po më vjen inat edhe mua që më paskan gënjer.

BESNIKU — Jani, dëgjo këtu ti! Mjaft m'u përdrohë! Akoma vazhdon?!

JANI — (*I hutuar.*) S'po të kuptoj.

BESNIKU — (*Nxjerr nga xhepi opingën e fëmijës.*) Fëmija i rrëmbyer ka lënë shenjën e fundit mu te porta e kësaj shtëpie. Ku është fëmija?

JANI — Kjo është prova?

BESNIKU — Edhe vetë kjo strofkë është një provë,

edhe qenia jote këtu është një provë. Kemi edhe prova të tjera. Mjaft më, o Jani! Jepi fund atij roli që përpinqesh të luash!

JANI — Të lutem shumë, mua...

BESNIKU — Hiç mos m'u lut, po nxirrmë fëmijën!

JANI — Fëmijën? (*Sanijes*) Ka fëmijë këtu? Po pat, nxirre dhe mos e zgjat.

SANIJA — Këtu s'ka fëmijë, prandaj, të lutem, mos na bjerë më qafë kot së koti.

BESNIKU — As me urdhërin e «Veshit» nuk e nxirrni fëmijën? (*Jani dhe Sanija shtangin në vend dhe e humbasin gjakftohtësinë e tyre.*)

JANI — Si the, si the?

BESNIKU — As me urdhërin e «Veshit» thashë nuk e nxirrni fëmijën?

JANI — Çfarë «Veshi», more? Ç'është ky «Veshi», more shoku Besnik?

BESNIKU — Apo mos zoti «Bakall» me zonjën «Hanëm», presin urdhërin e «Babait», ë?

JANI — Demek ti...

BESNIKU — I dimë të gjitha, o Jani, që nga lidhjet tuaja me «Babanë» dhe me «Farefisin» e deri tek ato mizat që u kini hedhur fshatarëve për të mos i çuar fëmijët në shkollë. E dimë mirë të gjithë veprën tuaj të poshtër, me rrënje e me degë. Dhe tani, nxirrmëni fëmijën dhe mos e zgjatni!

JANI — Ti dhe fëmija s'dilni të gjallë prej këtej.

BESNIKU — Po e gjeti gjë fëmijën, zoti «Bakall», do t'i shtosh telashet vetes.

JANI — (*I hutuar.*) Si the, si the? Zoti «Bakall»?

BESNIKU — Kështu sikur të pëlqen të të quajnë, apo jo?

JANI — (*Nxjerr revolen*). Unë nuk fal lehtë, o Besnik!

BESNIKU — As unë nuk trembem lehtë, o Jani.
(*I kthen automatikun.*)

SANIJA — (*Tepër nervoze.*) Pse s'qëllon t'u thaftë dora!

BESNIKU — Nuk ka aq forcë, jo. Nuk e sheh si i dridhet dora? Ju jeni mësuar të qëlloni në errësirë dhe prapa shpine.

JANI — Atëhere ti do të jesh i pari që do ta qëlloj ballë për ballë.

BESNIKU — Nuk shkon pa llogari ti, o Jani, jo. Vetë zanati yt prej tregtari të ka mësuar të jesh i saktë në llogari. (*Jani tenton të iki, po dikush i pret rrugën.*) Nuk jam vetëm, o Jani. Ti e di mirë këtë. Ne, ca më shumë se ju, nuk gabojmë në llogari. (*Jani diçka sheh në dritare dhe nga frika i bie revolja nga duart. Sanija turret ta marrë, por ushtari e merr më parë.*)

JANI — Lëre, Sano! E ke kot! Mori fund!

SANIJA — Mallkuar qoftë kjo fara juaj e hidhur!

BESNIKU — S'i mban më kjo tokë lutjet dhe mallkimet tuaja.

SANIJA — Atëherë u përbystë kjo tokë!

BESNIKU — Ç'ishte për t'u përbysur, u përbys një herë.

SANIJA — Dhe ti kujton se me ne mori fund gjithçka?

BESNIKU — Ne e dimë që ju dhe bëmat tuaja kurrë s'kanë fund, prandaj do t'ju mbajmë gjithmonë në majë të shinjestrës!

JANI — Po që ju urrejtmë, e dini?!

BESNIKU — E vëtmja fjalë e drejtë që the sonte,

o Jani, dhe unë ta besoj, ta besoj plotësisht, sepse më të fortë e kam edhe unë atë ndjenjë pér ju dhe pér farën tuaj. Po u zbut kjo ndjenjë, mjrë ky popull! Dhe tani, Jani, nxirr-më fëmijën, se e kérkojnë prindërit!

JANI — Në atë dorë që është ai fëmijë, zor të dalë i gjallë prej këtej.

BESNIKU — Ai do të jetojë, o Jani. (*Në thellësi të shtëpisë ndihen dy krisma të thata, pastaj një britmë tmerri e lemerie dhe një thirrje fëmije. Të gjithë shtangen, duke vështruar njëri-tjetrin. Ndihen këmbë që ngjitin shkallët dhe që sa vijnë e afrohen. Hapet dera dhe hyn Piloja me një sëpatë të përgjakur në njérën dorë dhe në dorën tjetër mban fëmijën.*)

SANIJA — Ç'bëre, mor matuf?!

PILOJA — E vrava!

SANIJA — E vrave?!

PILOJA — Kérma si ai i rëndohen kësaj toke. Kishte hyrë në bodrum dhe po matej të therrte këtë fëmijë. Ti e fute atje, prandaj të kam rixha ty dhe këtij kodoshit tënd të mos më lëvizni më, se do të më futni prapë në «gjynah»! Ashtu, de! Sus, qena! (*Piloja mezi mbahet e lëkundet.*)

BESNIKU — Ç'ke, xha Pilo?

PILOJA — *Asgjë, mor bir, asgjë! Jam pak i lodhur. Pleqëri hesapi. Nuk di...*

BESNIKU — Të lumtë, xha Pilo!

PILOJA — (*Fëmijës.*) Eja ndihmoje pak gjyshin të ulet. Rri këtu pranë meje. Ashtu de. Pëllumbi i gjyshit. I kuit je. more bir?

FËMIJA — Jam i Malo Gurit.

PILOJA — I Malo Gurit nga Gorrifica?

FÉMIJA — Po gjysh.

PILOJA — Si mor i Malos? E po dëgjo këtu, pëllumbi i gjyshit, ik, ik bir, se kushedi se sa merak është bërë i ziu Malo.

BESNIKU — Do të shkosh te zyrat e këshillit të Pishës se aty të pret babai Nisu!

FÉMIJA — Faleminderit, gjysh! Faleminderit, xhaixhi!

BESNIKU — (Dikujt në hyrje.) Sazan, le ta përcjellë Sadiku.

PILOJA — (Puth fémijën.) Ik, ik o pëllumb i gjyshit. (Fémija del.)

SANIJA — (Pilos.) Bukur ma punove, o të zëntë buka ime!

PILOJA — Ta pata borxh e nuk kisha si të vdisja pa të ta larë. Po prapë më mbetesh.

SANIJA — Prapë të mbetkam, the?!

PILOJA — Domosdo që më mbetesh. I thonë një jetë të tërë vuajtjesh dhe mundimesh në këtë derë. Më latë kështu, kërcu të thatë, njeri pa njeri, sepse s'deshte as yt atë, as yt shoq e as ti vetë që edhe unë të shijoja gëzimin e fémijës. (Hyn Nurija e alarmuar dhe shpérthen.)

NURIJA — Sanije, o e zeza Sanije! I gjithë fshati është turur drejt shtëpisë sonë. Ja, erdhën, erdhën! (Sheh Besnikun dhe shtanget).

SANIJA — Asaj që iu ruajtëm nuk i shpëtuam dot, o motë.

BESNIKU — Ose më saktë, kush luan bishtin ne i presim kokën! (Trokët dera me forcë pastaj shpérthehet dhe hyjnë Rrapoja, Fatka, Nurka, Kasoja, Teli, Maliqi, Rustemi, Shega, një shoqe

e saj, Fatimja, një oficer i ndjekjes, dy tre ushtarë, fshatarë, të gjithë të armatosur.)

RRAPOJA — (Besnikut.) Na rrëzove këmbët, more bir! Ku s'po të kërkojmë. Po ato krisma ç'qenë?

BESNIKU — Krismat e fundit të asaj bishe të vëtme që kishte shpëtuar.

OFICERI — Ku është?

BESNIKU — I lau xha Piloja hesapet me të. (Zëra miratimi për Pilon.)

RRAPOJA — E po mirë, de, kështu më thuaj. Uf! (Janit dhe Sanijes.) Hë, farë e ndyrë, farë e ndyrë! Tërë jetën vetëm të ligën patët për zanat.

OFICERI — (Rrapos.) Shoku kryetar?

RRAPOJA — Po, mor po. Mbërtheji! Akoma m'i lë, a?

OFICERI — Në emër të popullit, jeni të arrestuar!

SANIJA — Ç'është kjo?

BESNIKU — Diktatura e proletariatit. (Në skenë fusin Hyskën të lidhur.) Ngriji sytë, o zoti «Bakall», dhe vështroje këtë mostër, që fshihej pas emrit «Veshi».

RRAPOJA — Këtë kolerë, thuaj!

BESNIKU — Kujtuat se ky «Vesh» mund të përgjonte ədo gjë. Po ju harruat që janë gjithë këta sy e veshë (Tregon masën), që vigjëlojnë ditë e natë. Ja forca jonë mbi ju!

RRAPOJA — (Hyskës.) Ç'bushtër të polli, moj maviye e ndyrë? E përsë e katandise veten në këtë gjendje, ë? Ke ngrënë edhe bukën timë, që harram të qoftë. Po si s'm'u tha dora e të të kisha hedhur një çikë helm në sahanin tënd. Më mirë të kisha ngordhur, se sa të

kishe arrië këtu. Po me Pirron c'pate more? Apo pse s't'u bë ortak, ë? I rrojte bishtin, i rrojte! Gjallë e shëndoshë si molla është. Yyyy, farë e ndyrë!

HYSKA — Unë...

RRAPOJA — Qepe bushtrën, se të njohim tani. Hë, m'u përdrodhe atë natë që u dogjën depot, po tani c'do të thuash, hë? Fol, de!

HYSKA — (Bie më gjunjë.) Unë jo, o Rrapo. Për atë perëndi! Ato i dogji Dauti.

RRAPOJA — Dauti, the?! Hë, po kot s'flisja unë i ziu. E, o Fatkë, ja fakti! Mbërthejeni edhë atë maskara!

SANIJA — (Hyskës.) Lepur!

RRAPOJA — Hiqmini sysh këto kolera, se edhe era e tyre më tërbon. (Oficeri me ushtarë largohen me të arrestuarit. Në këtë çast Piloja lëkundet dy tri herë, nxjerr një rënkim të lehtë dhe rrëzohet. Të gjithë turren drejt tij.) Po ky qenka plagosur, more.

ZËRA — O burra ta çojmë shpejt në spital.

RUSTEMI — Po shkoj të sjell qerren time.

PILOJA — (I bën Rrapos me shenjë të afrohet dhe pastaj flet me rrokje të shkëputura.) Në shkallët e bodrumit, pas kamares së tretë, janë... shkon i merrni!

RRAPOJA — Hidhu, o Nurkë, me nja dy shokë. (Dalin Nurka dhe dy të tjérë.) Mbahù, o Pilò, se tani ia arritëm asaj që donim. Do ngrejmë kooperativën sot, vëlla.

PILOJA — Ta gëzoni, pa unë, a-ha, o Rrapo!

RRAPOJA — Dale, de! Mos e lësho kaq shpejt veten! Sa ke duruar ti.

PILOJA — Ej! (*Hyn Nurka me shokët dhe sjellin paratë në teneqe.*) Këtu është gjaku dhe djesa e pishanakëve. Haka të vejë te i zoti. Merrini dhe t'i gëzoni! (*Vdes.*)

RRAPOJA — Mos (*Bie mbi të, pastaj ngrihet, heq kapelen.*) Vdiq, o vëllezër! (*Të gjithë heshtin.*)

BESNIKU — Vuajtjet dhe mundimet e kërrusën dhe e thinjën këtë plak por shpirtin e pastër nuk ia cënuan dot. Ai dha gjithçka mund të jepte për njerëzit e për fshatin, që i deshte aq shumë.

RRAPOJA — Mirë e the, or bir!

KASOJA — Pilon të gjithë e kemi dashur dhe të gjithë lipset ta nderojmë, po zemra ma do ta nxjerrim nga shtëpia ime.

BESNIKU — Ashtu le të bëhet, o xha Kaso.

RUSTEMI — (*Hyn me nxitimi.*) Qerrja është gati. Ta çojmë në spital!

RRAPOJA — Mbaroi, o Rustem, mbaroi. Do ta çojmë te Kasoja. Ashtu u vendos.

KASOJA — Nisu, Nurkë! (*Nurka, Rustemi dhe dy fshatarë të tjerë e marrin dhe e nxjerrin xha Pilon.*)

RRAPOJA — O burra, të dalim nga kjo çerdhe, se na u zu fryma. (*Të gjithë dalin në ekstrem të shtëpisë, ku është mbledhur fshati.*)

KASOJA — U desh të vritej edhe ky plak, që një takëmi si unë t'u hapeshin sytë e të shpëtonin nga turpi. Dëgjo këtu, o Besnik! Edhe ti, o Rrapo! Pisk e patët me një takëm si unë, o vëllezër, po ju s'na u ndatë, jo. Të madhe e paskeni zemrën ju komunistët dhe mirë bëni, gjersa luftoni për të fituar njerëzit.

Mua më fituat të tèrin. O Rrapo! Shënomëni
dhe mua në kooperativë!

ZËRA — Shënomëni dhe mua! Shënomëni dhe mua!
Shënonani edhe ne!...

BESNIKU — Ju lumtë, motra dhe vëllezër! (*Duke parë fshatin dhe fushën*) Pisha jonë e dashur
dhe e bukur. Edhe për ty gdhin netë pa gjumi
më Partia, që ti të bëhesh më e begatë dhe
më e bukur, që njerëzit e tu të jetojnë të
lumtur paskëtaj.

RRAPOJA — Po domosdo, or vëllezër, se është Parti
e halleve, Parti e vegjëlisë kjo.

FATIMJA — Të lumtë goja, Rrapo!

BESNIKU — Shumë tokë na kanë grabitur shku-
rret dhe ferrat, kodrat dhe kënetat, motra dhe
vëllezër! Të gjitha do t'i pastrojmë, do t'i
gjelbërojmë, për të shtuar tokën tonë, tokën
e bukës sonë.

ZËRA — Ashtu do t'i bëjmë!

BESNIKU — Mbajeni mend këtë ditë, motra dhe
vëllezër, se këtë ditë Pisha jonë e ka ditën
e parë në rrugën e socializmit. Sot ne po
ngrejmë kooperativën këtu në Pishë dhe këtë
do t'ia njoftojmë menjëherë Komandantit to-
në të dashur, që të gëzojë edhe Ai bashkë
me ne. (*Sipari.*)

FUND